



USHTRIA



Viti i 75-të i botimit Nr. 17 (827769)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 29 Prill 2022

Gjeneralmajor, prof. asoc. Bajram Begaj : Turqia është dhe mbetet një partner strategjik

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të SFARSH, gjeneralmajor, prof. asoc. Bajram Begaj, i shoqëruar nga komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralbrigade Arben Kingji dhe përfaqësues të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, zhvilloi një vizitë zyrtare në Ankara, Turqi, me ftesë të homologut të tij, gjeneral Yaşar Güler. Gjatë vizitës në Ankara, gjeneralmajor Begaj, fillimisht vendosi kurorë në Memorialin Mauzole në nderim të themeluesit

të Republikës së Turqisë, Mustafa Kemal Atatürk. Më pas, gjeneralmajor Begaj u prit me nderimet më të larta ushtarake dhe zhvilloi një takim me shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura Turke, gjeneral Yaşar Güler. Në takimin me gjeneral Güler u nënvizua rëndësia e bashkëpunimit ushtarak dypalësh dhe aktivitetet e përbashkëta midis Forcave të Armatosura. "Bashkëpunimi në fushën e Mbrojtjes është

intensiv dhe për Shqipërinë, Turqia është dhe mbetet një partner strategjik me marrëdhënie të shkëlqyera. Falënderimet më të përzemërta për shtetin turk për të gjithë ndihmën, asistencën dhe mbështetjen e dhënë ndër vite për edukimin dhe arsimimin ushtarak, mbështetjen e vazhdueshme mjekësore për Forcat e Armatosura, por edhe ndihmën për tejkalimin e pasojave...

» faqe 2



SHBA, KONFERENCË PËR SITUATËN NË UKRAINË

Peleshi: Do të mbështesim pa kushte popullin ukrainas



Ambasadorja e SHBA-së Yuri Kim vizitë në Zall-Herr

Me rastin e instalimit të ekipit të Brigadës së Asistencës së Forcave të Sigurisë së SHBA-së në Zall-Herr, që do të mbështesin personelin e Grup-Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë, Ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, znj. Yuri Kim vizitoi këtë regjiment, ku u prit nga komandanti i Forcës Tokësore Arben Kingji. Gjatë kësaj vizite u ndoqën nga afër sekuenca të trajnimeve stërvitore nga efektivët e batalionit të Dytë të Këmbësorisë...



» Faqe 2

Në Qendrën Stërvitore të Komandës Mbështetëse zhvillohet ceremonia e përfundimit të Kursit EOD

Në mjediset e Qendrës Stërvitore të Komandës Mbështetëse u zhvillua ceremonia e përfundimit të kursit EOD (Explosive Ordnance Disposal), ceremonia e përfundimit të Kursit EOD Niveli II dhe Kursit Bazë të sigurisë fizike dhe menaxhimit të municioneve. Të pranishëm në këtë ceremoni ishin komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneralbrigade Ilir Xhebexhia, përfaqësues nga Policia e Shtetit, përfaqësues nga zyra ODC si dhe pjesëtarë nga Shtabi i Komandës Mbështetëse dhe komandantët e strukturave të saj...



» Faqe 4

Udhëtimi 71-vjeçar i kaltërsive Shqiptare

Gjeneralbrigade Astrit Jaupi (ish-komandant i Forcës Ajrore) me një eksperiencë të gjatë si aviator dhe drejtues force, në kremtimin e 71-vjetorit të krijimit të Armës së Aviacionit vjen për lexuesin me një rrëfim historik të jetës së tij dhe aktivitetit në vite të aviacionit luftarak shqiptar. Si ka nisur udhëtimi juaj drejt kaltërsive? Kam mbaruar shkollën 8-vjeçare dhe të mesmen ekonomike në qytetin e Korçës. Më pas kërkova për të vazhduar Shkollën e Bashkuar dhe në shtator të vitit 1971 fillova shkollën e aviacionit për pilot në Vlorë. Në vitin 1972 bëmë fluturimin e parë me 'Tip 61' për studentët. Në nëntor të vitit 1973...



» Faqe 6-7

Vizita

Ambasadorja e SHBA-së Yuri Kim vizitë në Zall-Herr

Me rastin e instalimit të ekipit të Brigadës së Asistencës së Forcave të Sigurisë (SFAB) së SHBA-së në Zall-Herr, që do të mbështesin personelin e Grup-Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë, Ambasadorja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, znj. Yuri Kim vizitoi këtë regjiment, ku u prit nga komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji. Gjatë kësaj vizite u ndoqën nga afër sekuenca të trajnimeve stërvitore nga efektivet e batalionit të Dytë të Këmbësorisë, trajnime të cilat do të zhvillohen mes dy ushtrive tona në vazhdimësi.



SHEFI I SHTABIT TË PËRGJITHSHËM TË FARSH, GJENERALMAJOR, PROF. ASOC. BAJRAM BEGAJ

"Turqia është dhe mbetet një partner strategjik"

Mirënjohje për ndihmën, asistencën, dhe arsimimin ushtarak të dhënë ndër vite për Forcat e Armatosura"

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor, prof. asoc. Bajram Begaj, i shoqëruar nga komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Arben Kingji dhe përfaqësues të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, zhvilloi një vizitë zyrtare në Ankara, Turqi, me ftesë të homologut të tij, gjeneral Yaşar Güler.

Gjatë vizitës në Ankara, gjeneralmajor Begaj, fillimisht vendosi kurorë në Memorialin Mauzole në nderim të themeluesit të Republikës së Turqisë, Mustafa Kemal Atatürk.

Më pas, gjeneralmajor Begaj u prit me nderimet më të larta ushtarake dhe zhvilloi një takim me shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura Turke, gjeneral Yaşar Güler.

Në takimin me gjeneral Güler u nënvizua rëndësia e bashkëpunimit ushtarak dypalësh dhe aktivitetet e përbashkëta midis Forcave të Armatosura. "Bashkëpunimi në fushën e Mbrojtjes është intensiv dhe për Shqipërinë, Turqia është dhe mbetet një partner strategjik me marrëdhënie të shkëlqyera. Falënderimet më të përzemërta për shtetin turk për të gjithë ndihmën, asistencën dhe mbështetjen e dhënë ndër vite për edukimin dhe arsimimin ushtarak, mbështetjen e vazhdueshme mjekësore për Forcat e Armatosura, por edhe ndihmën për tejkalimin e pasojave të tmerrshme të tërmetit që goditi Shqipërinë në vitin 2019 dhe më pas për përballimin e pasojave nga pandemia Covid-19", - theksoi gjeneralmajor Begaj në fjalën e tij.



Gjeneral Güler nga ana e tij e falënderoi gjeneralmajor Begaj për vizitën si dhe vlerësoi maksimalisht bashkëpunimin ushtarak dypalësh, duke siguruar se Forcat e Armatosura turke do të vazhdojnë mbështetjen, duke rritur nivelin e asistencës në fushën e trajnimit dhe arsimimit ushtarak, stërvitjes si dhe modernizimit të FARSH.

Vizita e delegacionit vijoi më tej në Komandën e Forcës Tokësore dhe atë të Forcave Speciale turke, ku u diskutua për bashkëpunimin ndërmjet Forcave tona të Armatosura, në kuadër të stërvitjeve, trajnimeve dhe aktiviteteve me NATO-n, po ashtu edhe ato të përbashkëta midis dy vendeve.



BASHKËPUNIMI
"Bashkëpunimi në fushën e Mbrojtjes është intensiv dhe për Shqipërinë, Turqia është dhe mbetet një partner strategjik me marrëdhënie të shkëlqyera. Falënderimet më të përzemërta për shtetin turk për të gjithë ndihmën, asistencën dhe mbështetjen e dhënë ndër vite për edukimin dhe arsimimin ushtarak, mbështetjen e vazhdueshme mjekësore për Forcat e Armatosura, por edhe ndihmën për tejkalimin e pasojave të tmerrshme të tërmetit që goditi Shqipërinë në vitin 2019 dhe më pas për përballimin e pasojave nga pandemia Covid-19", - theksoi gjeneralmajor Begaj në fjalën e tij.

STAFI

ANJEZA MUSOLLARI
Shefe e Sektorit të
Botimeve & Kryeredaktor

Gazetarë:
Mimoza **GOLIKJA**

Redaktore/ korrektore:
Suela **HODA**

Graphic Designer:
Afërdita **HYSAJ**

ADRESA:
Rruga e Dibrës/
Garnizoni "Skënderbej"

SHBA, konferencë për situatën në Ukrainë

Peleshi: Do të mbështesim pa kushte popullin ukrainas

Ministri i Mbrojtjes z. Niko Peleshi i shoqëruar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Bajram Begaj, morën pjesë në konferencën për Ukrainën, të thirrur nga sekretari i Mbrojtjes së SHBA-ve, Lloyd Austin, e cila u mbajt në bazën ajrore në Ramstein të Gjermanisë.

Në këtë konferencë, SHBA-të kishin ftuar të merrnin pjesë ministrat e Mbrojtjes dhe përfaqësues nga 40 vende të ndryshme, ku u diskutua mbi situatën në Ukrainë, nevojat që ky vend ka për asistencë në planin aktual dhe atë afatgjatë, dinamikat e luftimeve në Ukrainë, vlerësimi i kapaciteteve të tyre luftarake, mundësitë e kontributit për përmirësimin e këtyre kapaciteteve, si dhe rritjen e aftësive mbrojtëse të këtij vendi, në të ardhmen.

Në fjalën e tij, ministri Peleshi falënderoi organizatorët e këtij eventimi mjaft të rëndësishëm, veçanërisht sekretarin Austin, si dhe bëri një rezumë të mbështetjes që vendi ynë ka dhënë për Ukrainën. Ai u ndal në tre aspekte kryesore në të cilat konsiston kjo mbështetje, në rolin e Shqipërisë në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, si bashkëpunëmbajtëse me SHBA-të, në situatën dhe mbështetjen humanitare për pritjen dhe akomodimin e refugjatëve ukrainas, si dhe në suportin në terma praktikë që vendi ynë ka dhënë.

Në fund të fjalës së tij, zoti Peleshi siguroi pjesëmarrësit në këtë takim se, Shqipëria do të vijojë mbështetjen pa kushte për qeverinë dhe popullin ukrainas edhe në termat afatgjatë, përveç mbështetjes aktuale që jemi duke dhënë.

Urat "bailey"

Në prani të banorëve të zonës, ministri i Mbrojtjes z. Niko Peleshi inspektoi përfundimin e ndërtimit të urës "bailey" mbi lumin Dunavec në fshatin Voskop të Korçës. Kjo urë është 24 metra e gjatë dhe do t'u vijë në ndihmë dhjetëra banorëve të zonës.

I shoqëruar edhe nga drejtori i Agjencisë së Mbrojtjes Civile z. Haki Çako dhe kryetari i Bashkisë së Korçës z. Sotiraj Filo, ministri Peleshi vuri në dukje faktin se prej kohësh Forcat e Armatosura, përmes edhe koordinimit të Agjencisë së Mbrojtjes Civile janë në mbështetje të komuniteteve në të gjithë vendin për t'u lehtësuar jetën, duke qenë në gatishmëri edhe në raste fatkeqësish natyrore përkrah pushtetit vendor. "Janë dhjetëra hektarë ferma që janë në krahun tjetër të lumit dhe banorëve u duhet të bënin kilometra të tëra për të aksesuar pronat e tyre. Me investime të tilla, si kjo urë në Voskop apo edhe 25 të tjera që kemi ndërtuar në këto dy vitet e fundit në të gjithë Shqipërinë, janë mbi 20



Ministri Peleshi: Në dy vite janë ndërtuar 25 ura, bashkëpunim me pushtetin vendor për përgjigje ndaj të gjitha kërkesave



mijë banorë të cilëve u është lehtësuar veprimtaria, jo vetëm në ekonominë e tyre bujqësore, por edhe shërbimet publike siç janë p.sh. shkollat, qendrat shëndetësore, etj...". - u shpreh

ministri Peleshi. Ministri i Mbrojtjes u shpreh se bashkëpunimi me pushtetin vendor do të vijojë në të gjithë vendin për t'u përgjigjur të gjitha kërkesave, që siç tha ai janë të shumta.



Ceremonia

Komanda MBËSHTETËSE



“Kursi EOD Niveli II, si dhe ai bazë i sigurisë fizike dhe menaxhimit të municioneve janë kurse funksionalë, nëpërmjet të cilëve realizohet formimi profesional i ushtarakëve të FA-së, duke i përgatitur pjesëmarrësit në rolin e Instruktorit EOD si dhe angazhimin dhe përgatitjen në pikëpamje të menaxhimit e sigurisë së municioneve.

Në Qendrën Stërvitore të Komandës Mbështetëse zhvillohet ceremonia e përfundimit të Kursit EOD

Në mjediset e Qendrës Stërvitore të Komandës Mbështetëse u zhvillua ceremonia e përfundimit të kursit EOD (Explosive Ordnance Disposal,) ceremonia e përfundimit të Kursit EOD Niveli II dhe Kursit Bazë të sigurisë fizike dhe menaxhimit të municioneve. Të pranishëm në këtë ceremoni ishin komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ilir Xhebehxhia, përfaqësues nga Policia e Shtetit, përfaqësues nga zyra ODC si dhe pjesëtarë nga Shtabi i Komandës Mbështetëse dhe komandantët e strukturave të saj. Në fjalën e hapjes së këtij aktiviteti, komandanti Qendrës Stërvitore kolonel Ylli Zylaj theksoi rëndësinë e veçantë që kanë këto ceremoni duke u shprehur se: “Kursi EOD Niveli II, si dhe ai bazë i sigurisë fizike dhe menaxhimit të municioneve janë kurse funksionalë, nëpërmjet të cilëve realizohet formimi profesional i ushtarakëve të FA-së, duke i përgatitur pjesëmarrësit në rolin e Instruktorit EOD si dhe angazhimin dhe përgatitjen në pikëpamje të menaxhimit e sigurisë së municioneve. Kurset e zhvilluara më parë për menaxhimin e municioneve dhe eksplozivëve janë drejtuar nga instruktorë të USCGM dhe GOLDEN WEEST, ndërsa ky kurs është monitoruar prej tyre.”

Komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ilir Xhebehxhia, gjatë përshëndetjes së tij, i cilësoi këto kurse tepër të rëndësishëm në veçanti kursin EOD Niveli II.



“Nëpërmjet këtij kursi ne arritëm që të certifikojmë specialistët EOD në rolin e Instruktorit, të cilët do të zhvillojnë dhe ruajnë vazhdimësinë e këtyre kurseve në të ardhmen”, - u

shpreh gjeneral brigade Xhebehxhia.

Këto kurse u zhvilluan me një impetrim dhe përkushtim të madh si në aspektin e përgatitjes profesionale si EOD të një niveli më të avancuar ashtu

edhe nga ana instruktive dhe metodike. Në përfundim gjeneral Brigade Xhebehxhia falënderoi në veçanti ekipin e instruktorëve për kontributin e dhënë deri tani në Komandën Mbështetëse.

Në këtë kurs morën pjesë edhe kursantët nga Kosova si dhe nga Policia e Shtetit.

Në përfundim të ceremonisë u shpërndanë certifikatat për të gjithë kursantët.

Bashkëpunimi

Fregata e Forcës Detare franceze “Aconit F-713”, zhvilloi një vizitë portuale në portin e Durrësit

Fregata e Forcës Detare franceze “Aconit F-713”, zhvilloi një vizitë portuale në Portin e Durrësit. Vizita kishte në fokus forcimin dhe bashkëpunimin midis Forcës Detare shqiptare dhe Forcës Detare franceze, duke rritur shkallën e ndërveprimit përmes trajnimeve në kuadrin e angazhimeve të përbashkëta në NATO. Komandanti i fregatës franceze “Aconit F-713”, kapiten i rangut të dytë Jean-Bertrand Guyon u prit nga komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnan Agastra në një takim kortezie në Komandën e Forcës Detare.

Gjatë kësaj vizite portuale, midis personelit të Forcës Detare dhe personelit të fregatës franceze, në bordin e fregatës franceze “Aconit F-713” dhe anijes “Lissus” u zhvilluan disa stërvitje të përbashkëta sipas planit.

Me rastin e vizitës së fregatës



franceze “Aconit F-713”, shkëlqesia e saj znj. Elisabeth Barsacq, zhvilloi një pritje në bordin e fregatës franceze me pjesëmarrjen e autoriteteve të larta

ushtarake dhe përfaqësues diplomatikë të akredituar në vendin tonë.

Gjithashtu ambasadorja e Republikës së Francës në Shqipëri, shkëlqesia



e saj znj. Elisabeth Barsacq dhe komandanti i fregatës franceze “Aconit F-713”, kapiten i rangut të dytë Jean-Bertrand Guyon zhvilluan takime në

bashkinë dhe prefekturën e Durrësit.

Personeli i fregatës franceze zhvilloi gjithashtu edhe një vizitë kulturore në Muzeun Historik Kombëtar të Krullës.

ANJEZA MUSOLLARI
Shefe e Sektorit të Botimeve

Kush është më mirë të lindë - një vajzë apo një djalë?

Kush është më i mirë - një djalë apo një vajzë?

Pse nuk ka mjaft gra në planet?

Në fund të fundit, ju nuk do t'i tregoni një fëmijë të vërtetën që ju vetë nuk ju pëlqen. Gjatë shtatzënisë, megjithëse u thashë të gjithëve se për mua nuk kishte rëndësi se kush do të më lindte, unë vetë shpresoja fshehurazi për një djalë. Epo, për t'i sjellë gëzim babait, në mënyrë që të ketë një pasardhës. Për disa arsye, nuk mendoja fare për një pasardhës të nënës sime. Dhe po, nuk më interesonte vërtet për veten time. Prandaj lindën mendime të tilla. Por ju nuk mund t'ia shpjegoni këtë një fëmijë - ata nuk do ta kuptojnë, pavarësisht sa shumë përipiqeni. Dhe shija e pakëndshme me siguri do të mbetet. Mbat mend që babai im më tha se donte edhe një djalë. Dhe sapo i lindi vajza, ai rruante mustaqet, sipas premtimit që i kishte bërë vetes. Nga rruga, ai nuk ka fare mustaqe, kështu që për të, që të rruajë mustaqet e tij është një hap shumë vendimtar. Më pas dëgjoja shpesh se si, në bisedat me miqtë, ai fliste për familjen tonë "mbretërinë e mbiemrit", që do të thotë se ai ishte i vetmi burrë këtu. Tani jam pothuajse e sigurt se ai nuk donte të thoshte asgjë të keqe, por atëherë ishte e pakëndshme për mua të dëgjoja gjëra të tilla. Sikur e kam fajin që nuk kam lindur vajzë. Nga rruga, një herë pashë filmin "Sex and the City", dhe atje burri i njëjës prej heroinave pas lindjes së vajzës së saj të dytë deklaroi me krenari diçka të tillë: "Unë jetoj si në një kopsht lulësh! Në fund të fundit, janë pikërisht fjalë të tilla që e lejojnë vajzën të jetë krenare që është vajzë. Dhe gjithë jetën time të pavetëdijshme u pendova që nuk linda djalë."

Vetëm në sfondin e problemeve të tyre të të rriturve, vitet e tyre të fëmijërisë do të duken kaq të ndritshme. Sipas një sondazhi sociologjik, ku morën pjesë rreth 2 mijë persona në moshë pune, 2/3 e qytetarëve të vendit tonë mendojnë se më mirë të lindësh djalë sesa vajzë. Në të njëjtën kohë, ata përmendin faktet e mëposhtme si përparësitë më të rëndësishme të burrave ndaj grave:

1. Burrat e kanë shumë më të lehtë për t'u zhvilluar dhe për të arritur sukses në karrierë. Ata fitojnë shumë më tepër se gratë. Për ta është më e lehtë të gjejnë një punë prestigjioze dhe fitimprurëse.

2. Burrat mund të mos i bëjnë fare punët e shtëpisë, para martesës - nëna e tyre e bën këtë për ta, dhe pas martesës - gruaja. Një burrë mesatarisht shpenzon 30 minuta duke gatuar çdo ditë, dhe një grua kalon një të tretën e jetës së saj në kuzhinë. 3 milion burra, nuk e dinë se çfarë do të thotë të mbash një fëmijë në bark për 9 muaj, të lindësh dhe të ulësh në leje lehonie për 3 vjet.

4. Burrat nuk kanë pse të shqetësohen për pamjen e tyre. Ata nuk kanë nevojë të bëjnë manikyr, pedikyr, maska për fytyrën, kujdes për flokët, heqjen e vetullave... Kur sheh një këmishë ose këpucë të bukura në një

Diku më ra në sy kjo përgjigje:

- Po t'a kisha pasë në dorë do t'a grisësha çarçafin dhe nuk do të lejsha femën pa shkollë, pse grueja asht themeli i shoqnis njerzore, pse ajo asht burim i moralit, pse ajo asht nyjeja e shenjtë e qenëjes, pse ajo e mbjell farën e dashunis vëllazënore në mes të njerësve. E kur ajo lihet mbas dore vuen e tanë shoqnia njerzore.

Në faqen 78 pashë këtë shënim si përfundim i një mendimit të shfaqun ma sipër:

Un, po t'isha djalë, do t'i tregojsa botës mashkullore se dora që përkund djepin asht ajo që e rrotullon boshtin e fatit të njerzis, sepse ajo dhe vetëm ajo e drejton jetën kah horizontet e ndrituna ase t'errta. Por mjerisht s'jam djalë dhe si femën nuk mundem me e nxjerrë zanin.

Kah mbarimi vuna re:

Na, femnat Shqiptare, jemi krijesa të vorfëna që tue kangëtue, si të trenueme, shkojmë symbyllazi drejt greminës, drejt vorrit që na përgatisin të tjerët dhe na shtyjnë me u përplasë mbrenda. Po. Na duhet të jemi të qeshu na e gastore për t'i kënaqë kapricjet e burrave, lypset të jemi pa zemër e pa shpirt për t'i ngopë dëshirat e atyne që na kanë monopolizue. Por edhe në paçim zemër e shpirt, këta lypset të fonksjo nojnë vetëm simbas andjes s'atyne që na kanë robnue e jo për ata që na mund të dashunojmë. Oh fatkeqës! Sa e sa breza femnash, që erdhën para nesh, u banë viktimet e këtij zakoni t'egër dhe flia e asajë mendësiqe që kish për të vetmin qëllim të kënaqi kapricjet e një turme injorante, sunduese mbi fatin dhe jetën e atyne femna ve të mjera.

Nji „ta! ta!“ e fortë e buris s'automobilit dhe të truemit e shoferit me za t'egër, më shqitën nga fletori i Dijes.

“Sikur të isha djalë?”

dyqan, një burrë nuk do të shpenzojë paratë e tij të fundit për to. Burrat nuk i pëlqejnë blerjet.

6. Burrat nuk e kanë të nevojshme të fshehin moshën e tyre, ata nuk janë të mërzhitur për shkak të shfaqjes së rrudhave dhe flokëve të thinjura.

7. Reputacioni mashkullor nuk përkeqësohet pas marrëdhënies së parë seksuale. Ata mund të martohen në moshën 30-vjeçare, ndërsa askush nuk do të thotë se ai nuk është më i ri. Miqtë

vetëm do t'i kenë zili, dhe të afërmit do të jenë krenarë.

8. Burrat e përjetojnë më lehtë divorcin dhe kanë tre herë më shumë gjasa se gratë të rimartohen.

9. Kur sqaron marrëdhëniet me dikë një burrë mund të mbrohet me grushte, dhe askush nuk do ta quajë hysterik.

10. Burrat nuk kanë nevojë të ndryshojnë mbiemrin pas martesës, të gjithë anëtarët e familjes mbajnë mbiemrin e tij. Një burrë u jep fëmijëve të tij

jo vetëm jetën, por një mbiemër dhe patronim.

E çdo të kisha bërë ndryshe?! Kur prej shekujsh kërkohet barazi mes llojit të racës njerëzore.

Për shumë njerëz të jesh femër do të thotë të jesh përgjegjëse për çdo lloj pune që ka lidhje me pastrimin, gatimin, rritjen e fëmijëve dhe kaq!

Për shumë njerëz roli i femrës vazhdon të jetë i barabartë me një krahu pune dhe asgjë më shumë.

Për shumë njerëz një femër duhet të durojë çdo gjë pa bërë zë, pa ngritur krye dhe thjeshtë t'u nënshtrohet të tjerëve.

Ky është koncepti më i gabuar që dikush duhet të ketë për definicionin FEMËR.

Një femër është shumë më tepër se aq!

Një femër është një qenie po aq e fortë sa një mashkull për të mos thënë që është dhe më e fortë.

Një femër është ajo e cila përballet me çdo problem në shtëpi dhe e zgjidh duke mos e lënë partnerin e saj të kuptojë që ai problem ka ekzistuar ndonjëherë.

Një femër është ajo e cila pavarësisht sesi ndihet nuk i le të tjerët të kuptojnë se çfarë ka.

Një femër është ajo pa të cilën meshkujt do të ishin të mjerë. Është ajo e cila fal ngrohtësi kur ke nevojë, të mbështet atëherë kur ti e ndjen se e ke të gjithë botën kundër, nuk të le të marrësh vendime të gabuara për të cilat mund të pendohesh me vonë. Pra një femër është "superheroi" që fshihet pas sukseseve të një mashkulli. Një femër është ajo e cila pas çdo zhgënjimi, lëndimi apo humbjeje ngrihet më e fuqishme se më parë...

Nëse do më duhej ta krahasoja një femër me diçka do e krahasoja me një fenix, i cili digjet kthehet në hi dhe rilind më i fortë, më i bukur dhe kryelartë.

U përpoqën ta përdhosin, ta bëjnë të ndihet inferiore ndaj faktit që është 'e brishtë'.

Por ajo qëndroi e paepur ndaj çdo suferine sepse është FEMËR !



Intervista

FORÇA AJRORE



Më 24 prill të vitit 1951 është krijuar Arma e Aviacionit, pra kemi 71 vite rrugëtim të cilin unë do ta ndaja në tre faza të rëndësishme. Faza e parë ka qenë krijimi i tij. Që të krijon aviacion pas luftës kuptohet sa e vështirë ishte, duke ditur mungesën e informacionit që kishin shqiptarët e atyre viteve.

INTERVISTË ME GJENERAL BRIGADE
ASTRIT JAUPI, ISH-KOMANDANT I FORCËS AJRORE

Udhëtimi 71-vjeçar i kaltërsive Shqiptare

INTERVISTOI:
Shefe e Sektorit të Botimeve,
ANJEZA MUSOLLARI

General brigade Astrit Jaupi (ish-komandant i Forcës Ajrore) me një eksperiencë të gjatë si aviator dhe drejtues force, në kremtimin e 71-vjetorit të krijimit të Armës së Aviacionit vjen për lexuesin me një rrëfim historik të jetës së tij dhe aktivitetit në vite të aviacionit luftarak shqiptar.

Si ka nisur udhëtimi juaj drejt kaltërsive?

Kam mbaruar shkollën 8-vjeçare dhe të mesmen ekonomike në qytetin e Korçës. Më pas kërkova për të vazhduar Shkollën e Bashkuar dhe në shtator të vitit 1971 fillova shkollën e aviacionit për pilot në Vlorë. Në vitin 1972 bëmë fluturimin e parë me 'Tip 61' për studentët. Në nëntor të vitit 1973 ne vazhduam studimet në Republikën Popullore Kineze dhe fluturimet reaktive i bëmë për herë të parë në Kinë me 'Mig 17'. Në vitin 1974 u ktheva dhe u diplomova oficer me titullin pilot, ku menjëherë u emërova në Kuçovë me avionin 'Mig 15'. Më 2 prill 1976 u nisëm për studime në Republikën Popullore të Kinës për fluturim me avionin reaktiv luftarak 'Mig 19'. Në dhjetor të vitit 1976, pasi u ktheva si pilot në 'Mig 19', u emërova në regjimentin e ri të

Gjadrit në Lezhë (Zadrimë). Pas një viti na përzgjedhën mes shumë të tjerësh, tre pilotë për avionin 'Mig 21', kalimi i të cilit ishte bërë jashtë shtetit ne e realizuam në Zadrimë. Nga viti 1978 dhe deri në vitin 2003 unë fluturova me 'Mig 21' edhe si komandant i Forcës Ajrore, dhe si gjeneral. Pas vitit 2005, vit kur u mbyll aviacioni luftarak shqiptar, unë vazhdoja të shkoja në Farkë të fluturoja me helikopter si i vetmi regjiment që i rezistoi Forcave Ajrore, mjaft i fuqizuar sot, dhe është krenaria jonë.

Një jetë e tërë mes tokës dhe qiellit. Kush ishin disa nga etapat e karrierës suaj?

Gjatë karrierës time nga pilot i thjeshtë, që në Gjadër unë arrita të bëhem komandant i skuadriljes 'Mig 21', në vitin '92 u emërova zëvendës komandant i aviacionit në Ministrinë e Mbrojtjes. Më pas shkova për studime në Turqi në Akademinë e Luftës së Forcave Ajrore. Në shtator të vitit 1997 u emërova zëvendës komandant i Forcave Ajrore. Në fund-gushtin e vitit 2000, me krijimin e strukturave të reja si Forca Tokësore, Forca Detare, Forca Ajrore, Komanda Mbështetëse, u emërova komandant i Forcave Ajrore, si i pari i Forcave Ajrore, sepse deri atëherë kishin qenë të ndarë aviacioni dhe MKA më vete. Pasi mora këtë detyrë në kushte të vështira, pasi repartet ishin në mbarim e sipër pas ngjarjeve të vitit 1997, duhej një punë e madhe për të ringritur repartet dhe për të mbajtur gjallë aviacionin luftarak.

Në vitin 2001 mora gradën gjeneral brigade dhe vazhdoja si komandant i Forcave Ajrore deri në vitin 2008, si i vetmi gjeneral me tre mandate.

Një rrugëtim i gjatë, i vështirë me plot sakrificë personale dhe familjare. Aviacioni ka 43 dëshmorë, nuk ka grup që të mos ketë një shok të vrarë. Dhe duke qenë ky rrezik dhe këto vështirësi e bënin këtë zanafillë të fortë. Ne kurrë nuk e kemi llogaritur jetën. Edhe familjet tona jetonin me ankthin tonë. Çdo ditë e re e jona ishte një fillim jete i ri.

71 vite nga krijimi i Armës së Aviacionit Luftarak. Cilat janë etapat nëpër të cilat kaloi ai?



Më 24 prill të vitit 1951 është krijuar Arma e Aviacionit, pra kemi 71 vite rrugëtim të cilin unë do ta ndaja në tre faza të rëndësishme.

Faza e parë ka qenë krijimi i tij. Që të krijon aviacion pas luftës kuptohet sa



e vështirë ishte, duke ditur mungesën e informacionit që kishin shqiptarët e atyre viteve. Megjithatë aviatorët e parë shqiptarë i takojnë vitit 1946.

Pilotët e parë janë zgjedhur nga forcat partizane, nga oficerët e rinj të shkollës së atëhershme.

Ndër ta mund të përmendim pilotin Niko Hoxha, Edip Ohri, Fari Bubsji,



Zyhdi Rada, Sazan Xhelo, Irakli Grazhdani etj. Grupi i parë kanë shkuar në ish-Jugosllavi. Babaçe Faiku, Hamit Ulqinjaku, Daut Gurabardhi (inxhinieri i parë i aviacionit) në Shqipëri. Në këtë kohë marrëdhëniet diplomatike me ish-Jugosllavinë u prishën dhe pilotët tanë u larguan për në Rusi.

Në Jugosllavi ne kemi dhe pilotin e parë që humbi jetën në vitin 1948 Ibush Vokshi nga Durrësi, i cili ra dëshmor.

Kjo rrugë krijimi ishte me këtë grup pilotësh, teknikësh të cilët në 1950 u kthyen dhe në 1957 erdhën avionët e parë nga Rusia 'PO 9' luftarakë turbo-helike, u montuan tek ne nga rusët, u bënë kontrollet teknike dhe fluturimet e para dhe me vendim të Këshillit

1951 filluan të vijnë specialistë dhe inxhinierë dhe në vitin 1955 vijnë rreth 30 avionë 'Mig 19'.

Në vitet 1960 patëm dhe dy aviatorë studentë të rrëzuar në ish-Bashkimin Sovjetik, të cilët u shpallën Dëshmorë të Atdheut.

Traktati i Varshavës, para viteve 1960, i fali Shqipërisë një skuadrilje me 'Mig19' të sofistikuara me radarë dhe mjete moderne të navigimit, të cilët u vendosën në Rinas, ku sapo ishte krijuar regjimenti me pilotët më të mirë që kishin mbaruar në Bashkimin Sovjetik. Në atë kohë erdhi dhe avioni i parë qeveritar si dhuratë për qeverinë shqiptare. Fluturimin e parë me të e bëri Babaçe Faiku dhe Hamit Ulqinaku si pilotë dhe kryeinxhinier Daut Gurabardhi (inxhinieri i parë dhe i talentuar i aviacionit shqiptar). Kjo ishte periudha e modernizimit të aviacionit pas viteve '60.

Çfarë ndodhi me prishjen e marrëdhënieve të Shqipërisë me ish-Jugosllavinë?

Studentet tanë pas prishjes së marrëdhënieve me ish-Jugosllavinë u larguan drejt Kinës, pra rreth viteve 1961-1962. Gjatë kohës që kthehen nga Kina, Shqipëria po përgatitej për të hapur shkollën e aviacionit dhe, më 11 maj 1962, u hap shkolla e parë e aviacionit shqiptar në Vlorë, ku komandant u emërua Babaçe Faiku, i cili drejtonte avionin qeveritar dhe ishte njëkohësisht dhe komandant i shkollës.

Filloi Republika Popullore Kineze të dërgonte avionët 'Mig 19', erdhën skuadrilje të tëra, u fuqizua regjimenti i Kuçovës me tre skuadrilje me 'Mig



Bruksel, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s takohet me drejtuesit e Parlamentit European

BE dhe NATO qëndrojmë së bashku në solidaritet me Ukrainën, kanë ofruar deri më tani 8 miliardë dollarë mbështetje ushtarake

Stoltenberg: Finlanda dhe Suedia do të mirëprehen krahëhapur në NATO, nëse vendosin të aplikojnë

Më 28 prill 2022, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg vizitoi Parlamentin European në Bruksel për një takim me Presidenten Roberta Metsola dhe për konferencën e presidentëve të shtatë grupeve politike në Parlament. Kjo është hera e parë që një Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s takohet me grupin e drejtuesve të partive të Parlamentit European. Sekretari i Përgjithshëm vlerësoi Parlamentin European për mbështetjen e tij të fortë ndaj Ukrainës dhe theksoi se partneriteti NATO-BE është jetik në këtë moment kritik për sigurinë tonë të përbashkët. Ai përmendi nivelin e jashtëzakonshëm dhe të paprecedentë të bashkëpunimit midis dy organizatave për një gamë të gjerë çështjesh, përfshirë Ballkanin Perëndimor, për kibernetikën, qëndrueshmërinë dhe sigurinë detare. Në një konferencë të përbashkët shtypi me Presidenten Metsola, Sekretari i Përgjithshëm theksoi se NATO dhe BE qëndrojnë së bashku në solidaritet me Ukrainën. Ai përshëndeti sanksionet e forta ekonomike të BE-së ndaj Rusisë. Ai deklaroi se deri më sot, aleatët e NATO-s janë zotuar dhe kanë ofruar të paktën 8 miliardë dollarë mbështetje ushtarake për Ukrainën dhe vazhdojnë të rriten.

“Unë kam qenë shumë herë në Parlamentin European, por kjo është hera e parë që takohem me këtë grup ekskluziv të Presidentëve, pra me parti të ndryshme politike, ndaj mezi pres t’i takoj të gjithë dhe veçanërisht tani kur shohim që Bashkimi European dhe NATO qëndrojmë së bashku në solidaritet me Ukrainën, Bashkimi European ka vendosur sanksione të paprecedentë, po ofron mbështetje ekonomike për Ukrainën. Aleatët e NATO-s gjithashtu kanë rritur mbështetjen e tyre për Ukrainën dhe deri më tani aleatët e NATO-s janë zotuar dhe kanë ofruar të paktën 8 miliardë dollarë amerikanë në mbështetje ushtarake për Ukrainën. Dhe ne shohim rëndësinë e shtimit të mëtejshëm të mbështetjes sonë për Ukrainën. Pra, bashkëpunimi NATO-BE ka qenë gjithmonë i rëndësishëm, por veçanërisht tani kur vlerat tona thelbësore, demokracia, sundimi i ligjit, respektimi i sovranitetit dhe integritetit territorial, sfidohen nga pushtimi brutal rus i Ukrainës. Është edhe më e rëndësishme që Bashkimi European dhe NATO të qëndrojnë së bashku”, -tha Stoltenberg.

I pyetur nga gazetarët se sa shpejt mund të shkojë procesi i anëtarësimit në NATO nëse Finlanda dhe Suedia vendosin të aplikojnë, Sekretari i Përgjithshëm tha se “Natyrishëm që Finlanda dhe Suedia duhet të vendosin nëse do të dëshironin të aplikojnë për anëtarësim në NATO apo jo. Por nëse vendosin të aplikojnë, Finlanda dhe Suedia do të mirëprehen krahëhapur në NATO. Finlanda dhe Suedia janë partnerët tanë më të ngushtë, janë demokraci të forta, të pjekura, anëtarë të BE-së dhe ne kemi punuar me Finlandën dhe Suedinë



për shumë e shumë vite. Ne e dimë se forcat e tyre të armatosura përbushin standardet e NATO-s, janë të ndërveprueshme me forcat e NATO-s, ne stërvitemi së bashku, ne ushtrohemi së bashku, dhe gjithashtu kemi punuar me Finlandën dhe Suedinë në shumë mis-

ione dhe operacione të ndryshme. Pra, nëse ata aplikojnë, ata do të mirëprehen dhe gjithashtu pres që procesi të jetë i shpejtë dhe se ata më pas mund të anëtarësohen në NATO pasi të jetë finalizuar procesi formal”, -tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s.

Dislokim dymujor në vendin aleat

Një detashment i avionëve luftarakë modernë F-35A dhe personeli nga Forca Ajrore Italiane vendoset në Islandë për dy muaj për të mbështetur përpjekjet e policisë ajrore të NATO-s në Veriun e Lartë. Misioni rutinë i planifikuar do të kryejë stërvitje rutinore dhe ushtrime fluturimi për Aleancën dhe do të sigurojë aeroplan interceptues për të mbështetur mbikëqyrjen ajrore islandeze me synimin për të mbajtur të sigurt hapësirën ajrore islandeze.

Gjermani: Një detashment luftarak i Forcave Ajrore Italiane F-35A u përgatit në 25 prill 2022, për t’u vendosur në Islandë në mbështetje të përpjekjeve të qëndrueshme të policisë ajrore të NATO-s në Veriun e Lartë.

Të bazuar në bazën ajrore Amendola, Itali, avionët luftarakë modernë F-35A po përgatiten për dislokimin e tyre dymujor në aleatin e NATO-s, Islandë, për misionin e planifikuar rutinë të sigurimit të avionëve interceptues për të mbështetur mbikëqyrjen ajrore islandeze. Autoriteti mbi avionët luftarakë do t’i mbetet Komandës Ajrore Aleate të NATO-s; Qendra Veriore e Operacioneve të Kombinuara Ajrore në Udem, Gjermani, do të kontrollojë

Italia mbështet policinë ajrore të NATO-s me vendosjen e F-35A në Islandë



taktikisht operacionet e detashmentit dhe do t’i lidhë ato në marrëveshjet e sigurisë kolektive të Aleancës.

“Pasi ishte aleati i parë që vendosi avionë luftarakë të gjeneratës së pestë në një mision të NATO-s jashtë vendit, Italia demonstroi një aftësi të qëndrueshme për të ofruar avionë luftarakë modernë për operacionet e Aleancës”, -tha koloneli Gianmarco Di Loreto, Komandanti i Task Forcës Italiane F-35A Ajrore në Islandë. Avionët tanë F-35A kanë fituar tashmë një përvojë

Aleatët dhe partnerët e NATO-s në stërvitjen e mbrojtjes kibernetike në shkallë të gjerë

“Locked Shields 2022”, mbi 2000 pjesëmarrës nga 33 vende

Aleatët dhe partnerët e NATO-s sapo kanë përfunduar stërvitjen “Locked Shields 2022”, stërvitjen më të madhe dhe më komplekse ndërkombëtare të mbrojtjes kibernetike. Stërvitja, e cila është krijuar për të përmirësuar qëndrimin e mbrojtjes kibernetike kolektive të Aleancës, u organizua nga Qendra e Ekselencës së Mbrojtjes Kibernetike të NATO-s (CCDCOE) në Tallin, Estoni dhe përfshiu më shumë se 2000 pjesëmarrës nga 33 vende. Partneri i NATO-s, Finlanda u shpall fituesja e përgjithshme e stërvitjes, me një ekip të përbashkët lituanëz-polak, që zuri vendin e dytë dhe Estonia në vendin e tretë.

MONS, Belgjikë: Përfundoi “Locked Shields 2022”, stërvitja më e madhe dhe më komplekse ndërkombëtare e mbrojtjes kibernetike.

Kjo stërvitje e mbrojtjes së rrjetit në kohë reale, e organizuar nga Qendra e Ekselencës së Mbrojtjes Kibernetike të NATO-s (CCDCOE) në Tallin, Estoni, po zhvillohet çdo vit që nga viti 2010 duke vënë në provë Aleancën, vendet anëtare të NATO-s dhe partnerët.

“Locked Shields” është një mundësi unike për pjesëmarrësit që të praktikojnë mbrojtjen e sistemeve kombëtare civile dhe ushtarake të IT dhe infrastrukturës kritike. Ajo kryhet në kushte presioni intensiv, me ekipe që kundërshtojnë seritë e sofistikuara dhe intensive të sulmeve kibernetike,” -tha Ian West, shefi i Qendrës së Sigurisë Kibernetike të NATO-s.

Këtë vit, për herë të parë, ushtrimi përfshinte simulimin e sistemeve të administrimit të rezervës dhe mesazheve financiare të një banke qendrore në mjedisin kibernetik për ushtrimin teknik.

Më shumë se 2000 pjesëmarrës nga 33 vende u përfshinë në stërvitjen e këtij viti, e cila u zhvillua midis 19 dhe 22 prillit. “Locked Shields 2022” përfshinte 24 vende anëtare si dhe partnerë që merrnin pjesë dhe merrnin rolin e Ekipëve kombëtare të Reagimit të Shpejtë Kibernetik të vendosur për të ndihmuar një vend imagjinar në trajtimin e një incidenti kibernetik në shkallë të gjerë. Përveç sigurimit të sistemeve komplekse të IT-së, ekipet pjesëmarrëse u sfiduan me raportimin e incidenteve, vendimmarrjen strategjike dhe zgjidhjen e operacioneve mjeko-ligjore, ligjore, mediatike dhe informative.

NATO ka Ekipet mbrojtëse të Reagimit të Shpejtë Kibernetik në gatishmëri 24 orë në ditë për të ndihmuar aleatët dhe çdo vit, mbrojtësit kibernetikë nga e gjithë Aleanca testojnë aftësitë e tyre në stërvitjet kryesore. Është pjesë e mbrojtjes kolektive që përdor teknologji realiste për të trajnuar ekipet kombëtare brenda një mjedisi ushtrimesh bazuar në një skenar imagjinar. NATO kryen këto stërvitje të rregullta për të përmirësuar më tej qëndrimin e mbrojtjes kolektive kibernetike të Aleancës.

e saj gjeografike, aleatët, në bashkëpunim me autoritetet islandeze, kanë rënë dakord që marrëveshja e duhur për të ndihmuar në mbajtjen e hapësirës ajrore islandeze të sigurt dhe të mbrojtur është që të mbajë një prani periodike të avionëve luftarakë të NATO-s, bazuar në bazën ajrore të NATO-s Keflavik. Fokusi i misionit të gatishmërisë në kohë paqeje është të kryejë stërvitje rutinë fluturimi dhe ushtrime për Aleancën për të përbushur kërkesat dhe nevojat e Islandës për të qëndruar e përgatitur, për të monitoruar dhe për të menaxhuar hapësirën e saj ajrore në kohë paqeje.

Detashmenti i Forcave Ajrore Italiane përbëhet nga më shumë se 130 gra dhe burra dhe katër avionë luftarakë F-35A, duke përfshirë pilotët, ekipazhin tokësor, personelin mbështetës dhe mbrojtjen e forcave. Ky është dislokimi i tretë i avionëve luftarakë italianë të gjeneratës së pestë në Islandë pas 2019 dhe 2020. Përpara kësaj, Italia mbështeti misionin me Eurofighter Typhoon për të mbrojtur hapësirën ajrore mbi aleatin në veriun e lartë në 2013, 2017, 2018 dhe 2019.

të konsiderueshme ndërkombëtare duke marrë pjesë në misionet e policisë ajrore të NATO-s në Islandë, por edhe në Estoni. Stafit gjithashtu ka ekzekutuar detyrën kombëtare QRA nga baza e tyre në vend dhe do të vazhdojë të trajnojë ekipazhet për të mbrojtur qiellin kombëtar dhe të Aleancës”, shtoi koloneli Di Loreto.

Sipas udhëheqjes së Rojës Bregdetare Islandeze, operacioni në vazhdim i NATO-s në Islandë është specifik dhe unik. Duke pasur parasysh vendndodhjen



Në këtë raport vjetor, për herë të parë, makinat janë në krye të listës së produkteve të njoftuara, e ndjekur nga lodrat. Gjithashtu, në kontekstin e pandemisë COVID-19, pajisjet mbrojtëse si maskat për fytyrën përbëjnë ende një pjesë të konsiderueshme të produkteve të njoftuara.



"Safety Gate"

Automjetet dhe lodrat kryesojnë listën e produkteve të rrezikshme jo ushqimore këtë vit

Komisioni European publikoi raportin e tij vjetor mbi "Safety Gate" (Porta e Sigurisë), sistemi i alarmit të shpejtë të BE-së për produktet e rrezikshme jo ushqimore. Raporti mbulon sinjalizimet e njoftuara gjatë vitit 2021 dhe veprimet e ndërmarra nga autoritetet kombëtare në përgjigje. Në këtë raport vjetor, për herë të parë, makinat janë në krye të listës së produkteve të njoftuara, e ndjekur nga lodrat. Gjithashtu, në kontekstin e pandemisë COVID-19, pajisjet mbrojtëse si maskat për fytyrën përbëjnë ende një pjesë të konsiderueshme të produkteve të njoftuara.

Në dritën e zhvendosjes së konsumit drejt platformave të blerjeve online, janë zhvilluar gjithashtu instrumente të reja për të mbrojtur më mirë konsumatorët që blejnë online dhe për të hequr produktet e rrezikshme nga tregu. Në përputhje me këto objektiva, Komisioni sot lançon gjithashtu një mjet të ri të mbikëqyrjes elektronike të quajtur "web crawler" që do të ndihmojë autoritetet kombëtare të zbulojnë ofertat në internet të produkteve të pasigurta të sinjalizuara në "Safety Gate".

Didier Reynders, Komisioneri për Drejtësinë, tha: "Safety Gate" është dëshmuar edhe një herë të jetë një mjet jetik për të mbajtur konsumatorët të sigurt nga produktet e rrezikshme. Unë jam gjithashtu krenar për përmirësimin dhe përforsimin e vazhdueshëm të sistemit. Është shumë e rëndësishme që "Safety Gate" të përgatitet për t'u përshtatur me mjedisin e ri të konsumatorit. Në këtë mënyrë, ne mund të sigurojmë që "Safety Gate" të mbetet një mjet efikas për Tregun Unik, duke mbrojtur konsumatorët në të gjitha rrethanat. Gjithashtu ka ndihmuar që pajisjet e përdorura në luftën kundër pandemisë të jenë të standardeve më të larta."

Gjetjet kryesore të raportit

Në vitin 2021, autoritetet e vendeve pjesëmarrëse të Rrjetit të Sigurisë shkëmbyen 2,142 sinjalizime përmes sistemit. Për herë të parë, numri më i lartë i sinjalizimeve u njoftua në kategorinë "mjetet motorike", e ndjekur nga "lodrat" dhe "aparartet dhe pajisjet elektrike". Për sa i përket mjeteve motorike, veprimet e ndërmarra kanë të bëjnë kryesisht me rikujtimet pas konstatimit të problemeve teknike, ndërsa për lodrat janë fokusuar tek prania e lëndëve kimike të rrezikshme, si dhe bateritë me butona. Për më tepër, problemet më të zakonshme të raportuara për aparatet dhe pajisjet elektrike lidhen me ekspozimin e pjesëve të ndezura dhe çështjet e mbinxehjes.

Ndërsa pandemia vazhdon, veprimet e mbikëqyrjes shfaqën një sërë produktesh të lidhura me COVID-19. Kishte shumë alarme në lidhje me pajisjet mbrojtëse, veçanërisht maskat mbrojtëse ishin në qendër të vëmendjes. Pesë rreziqet më të zakonshme të raportuara ishin lëndimet personale, kimikatet, zjarri, mbytja dhe goditjet



elektrike. Në total, 4 965 njoftime vijuese qarkulluan në "Safety Gate", duke treguar se Shtetet Anëtare monitorojnë nga afër alarmet dhe shpesh ndjekin masat shtesë të marra në vendet e tyre.

Raporti tregon se në vitin 2021, përdorimi i përgjithshëm i rrjetit të sistemit të alarmit të shpejtë u rrit midis 30 vendeve pjesëmarrëse (BE27 plus Islanda, Lihtenshtajni dhe Norvegjia), duke i mbajtur konsumatorët të sigurt nga produktet e rrezikshme.

Hapat e ardhshëm

Komisioni po lançon një mjet të ri të mbikëqyrjes elektronike të quajtur "web crawler". Mjeti do të mbështesë autoritetet kombëtare në zbulimin e ofertave në internet të produkteve të rrezikshme të sinjalizuara në "Safety Gate". Ky mjet do të identifikojë dhe do të renditë automatikisht secilën nga këto oferta, duke lejuar autoritetet e zbatimit të gjurmojnë ofruesin dhe të urdhërojnë tërheqjen efektive të këtyre ofertave. Kështu, ai do të ndihmojë në harmonizimin e qasjes aktuale të fragmentuar dhe adresimin e sfidave të monitorimit të shitjeve online të produkteve të rrezikshme.

Më 30 qershor 2021, Komisioni paraqiti gjithashtu një propozim për një Rregullorë të re të Përgjithshme të Sigurisë së Produkteve që zëvendëson Direktivën aktuale të Sigurisë së Përgjithshme të Produkteve. Rregullorja synon të modernizojë kuadrin e përgjithshëm për sigurinë e produkteve të konsumit jo ushqimor për të ruajtur rolin e tij si një rrjet sigurie për konsumatorët dhe për të përmbushur sfidat e sigurisë së produkteve të paraqitura nga produktet e reja të lidhura me teknologjinë dhe nga rritja e shitjeve në internet.

Në nivel ndërkombëtar, duke pasur parasysh marrëdhëniet e forta tregtare BE-SHBA dhe ngjashmëritë midis dy tregjeve, Komisioni European po fillon një dialog jozyrtar për mbrojtjen e konsumatorit me Komisionin e Sigurisë së Produkteve të Konsumatorit të Shteteve të Bashkuara për të forcuar më tej bashkëpunimin. Ky dialog do të mbulojë

rritjen e tregtisë elektronike, zgjerimin e teknologjive të reja, globalizimin e prodhimit dhe shitjeve me pakicë, si dhe nevojat specifike të grupeve vulnerabël të konsumatorëve. Kjo pason një dialog të parë jozyrtar mbi mbrojtjen e konsumatorit të mbajtur në mars nga komisioneri Reynders dhe kryetarja e Komisionit Federal të Tregtisë së Shteteve të Bashkuara, Lina Kahn.

Që nga viti 2003, "Safety Gate" mundëson shkëmbimin e shpejtë të informacionit midis shteteve anëtare të BE-së/ZEE-së, MB (Irlanda e Veriut) dhe Komisionit European në lidhje me produktet e rrezikshme jo ushqimore që paraqesin rrezik për shëndetin dhe sigurinë e konsumatorëve. Mund të ndërmerren veprimet e duhura përcjellëse dhe produktet mund të hiqen nga tregu. Komisioni menaxhon faqen publike të internetit "Safety Gate", e cila ka një ndërfaqe moderne dhe miqësore për përdoruesit për të lehtësuar procesin e njoftimit. Faqet janë përkthyer në të gjitha gjuhët e BE-së (përfshirë gjuhën gale që nga viti 2022), islandeze dhe norvegjeze. Bizneset mund të përdorin gjithashtu "Business Gateway" për të informuar autoritetet kombëtare shpejt dhe me efikasitet në lidhje me shqetësimet e sigurisë në lidhje me një produkt që ata kanë hedhur në treg.

Një veprim tjetër për mbrojtjen e konsumatorit është Premtimi i Sigurisë së Produkteve, i cili përcakton veprime specifike vullnetare të tregjeve për të hequr ofertat e produkteve të pasigurta nga platformat e tyre. Deri më sot, njëmbëdhjetë tregje online kanë nënshkruar këtë marrëveshje për të bashkëpunuar me Shtetet Anëtare për të hequr produktet e rrezikshme nga faqet e tyre të internetit: bol.com, eMAG, Wish.com, AliExpress, Amazon, eBay, Rakuten France, Allegro, Cdiscount, Etsy dhe Joom.

Akti i Shërbimeve Dixhitale: Interneti, një hapësirë më e sigurt për qytetarët europianë

Një hap i rëndësishëm është bërë me marrëveshjen e përkohshme politike të arritur mbi Aktin e Shërbimeve Dixhitale (DSA) ndërmjet Këshillit dhe Parlamentit European. Për sa i përket ambicieve, natyrës së aktorëve të rregulluar dhe aspektit inovativ të mbikëqyrjes së përfshirë, DSA është i pari në botë në fushën e rregullimit dixhital.

DSA ndjek parimin se ajo që është e paligjshme jashtë linje duhet të jetë gjithashtu e paligjshme në internet. Ai synon të mbrojë hapësirën dixhitale kundër përhapjes së përmbajtjes së paligjshme dhe të sigurojë mbrojtjen e të drejtave themelore të përdoruesve.

Fushëveprimi

DSA do të zbatohet për të gjithë ndërmjetësit online që ofrojnë shërbime në BE. Detyrimet e paraqitura janë në përpjesëtim me natyrën e shërbimeve në fjalë dhe të përshtatura me numrin e përdoruesve, që do të thotë se platformat shumë të mëdha në internet (VLOP) dhe motorët e kërkimit shumë të mëdhenj në internet (VLOSE) do t'i nënshtrohen kërkesave më të rrepta. Shërbimet me më shumë se 45 milionë përdorues aktivë mujorë në Bashkimin European do të bien në kategorinë e platformave shumë të mëdha online dhe motorëve shumë të mëdhenj të kërkimit.

Për të mbrojtur zhvillimin e bizneseve fillestare dhe ndërmarrjeve më të vogla në tregun e brendshëm, ndërmarrjet mikro dhe të vogla me nën 45 milionë përdorues aktivë mujorë në BE do të përjashtohen nga disa detyrime të reja.

Qeverisja

Për të garantuar zbatimin efektiv dhe uniform të kërkesave sipas DSA, Këshilli dhe Parlamenti kanë vendosur t'i japin Komisionit kompetencë ekskluzive për të mbikëqyrtur VLOP dhe VLOSE për detyrimet specifike për këtë lloj aktori.

Ato do të mbikëqyrin në nivel europian në bashkëpunim me shtetet anëtare. Ky mekanizëm i ri mbikëqyrës ruan parimin e vendit të origjinës, i cili do të vazhdojë të zbatohet për aktorët dhe kërkesat e tjera të mbuluara nga DSA.

Tregjet online

Duke pasur parasysh rolin e rëndësishëm që luajnë këta aktorë në jetën e përditshme të konsumatorëve europianë, DSA do të vendosë një detyrë përkujdesjeje në tregjet kundrejt shitësve që shesin produktet ose shërbimet e tyre në platformat e tyre online.

Tregjet në veçanti do të duhet të mbledhin dhe shfaqin informacion mbi produktet dhe shërbimet e shitura në mënyrë që të sigurojnë që konsumatorët të jenë të informuar siç duhet.

Rreziqet sistematike të platformave shumë të mëdha dhe motorëve të kërkimit DSA prezanton një detyrim për platformat dhe shërbimet dixhitale shumë të mëdha për të analizuar rreziqet sistematike që ato krijojnë dhe për të kryer analizën e reduktimit të rrezikut. Kjo analizë duhet të kryhet çdo vit dhe do të mundësojë monitorim të vazhdueshëm që synon reduktimin e rreziqeve që lidhen me: Shpërndarjen e përmbajtjes ilegale; Efektet negative mbi të drejtat themelore; Manipulimi i shërbimeve me ndikim në proceset demokratike dhe sigurinë publike; Efekte negative në dhunën me bazë gjinore dhe mbi të miturit dhe pasojat që rëndojnë në shëndetin fizik ose mendor të përdoruesve.

Modele të errëta

Për platformat dhe ndërfaqet online të mbuluara nga DSA, bashkë-ligjvënësit kanë rënë dakord të ndalojnë ndërfaqet mashtruese të njohura si 'modele të errëta' dhe praktikat që synojnë të mashtrjnë përdoruesit.

Sistemet rekomanduese

Sistemet e rekomandimeve gjenden në shumë përdorime të përdoruesve në internet, duke i lejuar ata të aksesojnë shpejt përmbajtjen përkatëse.

Kërkesat e transparencës për parametrat e sistemeve rekomanduese janë futur në mënyrë që të përmirësohet informacioni për përdoruesit dhe çdo zgjedhje që ata bëjnë. VLOP dhe VLOSE do të duhet t'u ofrojnë përdoruesve një sistem për rekomandimin e përmbajtjes që nuk bazohet në profilizimin e tyre.

Mekanizmi i krizës

Në kontekstin e agresionit rus në Ukrainë dhe ndikimin e veçantë në manipulimin e informacionit në internet, teksti i është shtuar një artikull i ri që prezanton një mekanizëm reagimi ndaj krizave. Ky mekanizëm do të aktivizohet nga Komisioni me rekomandimin e bordit të Koordinatorëve Kombëtarë të Shërbimeve Dixhitale. Do të bëjë të mundur analizimin e ndikimit të aktiviteteve të VLOP-ve dhe VLOSE-ve në krizën në fjalë dhe vendosjen e masave proporcionale dhe efektive që do të ndërmerren për respektimin e të drejtave themelore.

Mbrojtja e të miturve në internet

Platformat e aksesueshme për të miturit do të duhet të vendosin masa të veçanta mbrojtëse për të garantuar sigurinë e tyre në internet, veçanërisht kur ata janë të vetëdijshëm se një përdorues është i mitur. Platformat do të ndalohen të paraqesin reklama të synuara bazuar në përdorimin e të dhënave personale të të miturve, siç përcaktohet në ligjin e BE-së.

Nga argëtimi i thjeshtë deri te mbledhja e avancuar e të dhënave, dronët modernë mbulojnë një gamë të gjerë përdorimesh

Lloje të ndryshme të dronëve

Ka lloje të ndryshme dronësh, dhe ato shërbejnë për shumë qëllime. Dronët mund të përdoren për qëllime ushtarake në operatione zbulimi ose misione luftarake. Ato mund të përdoren gjithashtu për përdorim komercial nga fotografë ose videografë, ose edhe nga amatorë, për të kapur pamje nga një pikë e favorshme unike.

Në fund të fundit, ka një shumëllojshmëri të gjerë të dronëve, si nga madhësia e tyre ashtu edhe nga përdorimi që gjejnë, secili i projektuar për të përmbushur funksione të caktuara. Kjo aftësi për të përshtatur një gamë kaq të gjerë të nevojave operationale, duke ruajtur ende të njëjtën ide thelbësore, të një mjeti ajror pa pilot (UAV), është në thelb të asaj që i bën dronët unikë.

Shumë dronë të vegjël komerciale montohen lehtësisht dhe janë shumë të personalizueshëm, duke i afruar fëmijët, adoleshentët dhe studentët e kolegjit me dizajnin aeronautik.

Dronët gjithashtu mund të jenë mjaft të dobishëm për kompanitë në mënyra të ndryshme, si për shembull për gjurmimin e Sistemit të Pozicionimit Global (GPS), ose për shkrepje profesionale nga lart, të cilat do të ishin shumë të vështira ose të shtrenjta për t'u realizuar me një ekuipazh kamerash në aeroplan ose helikopter.

Në fushën ushtarake dronët kanë gjetur përdorim shumë të madh kohët e fundit. Përdorimi i dronëve në luftën moderne, nuk mund të mohohet se ka ndryshuar natyrën e fluturimit dhe goditjeve taktike.

Kjo është një përmbledhje e dronëve modernë komerciale dhe ushtarakë që përdoren sot:

1. Dronët me një helikë të vetme



“RQ 8 Fire Scout” UAV

Këto janë deri tani disa nga llojet më themelore të dronëve. Siç do të nënkuptonte emri, ai përdor një rotor të vetëm (përveç njësisë së bishtit në disa raste) dhe shpesh mund të gjenerojë shtytje në mënyrë më efektive sesa homologët e tyre me shumë rotorë. Kjo mund t'i bëjë ato idealë për kohë më të gjata fluturimi.

Duke qenë kështu, ka të meta në dizajn. Së pari, dizajni me të vetëm i kombinuar me natyrën e tyre shpesh me energji gazi mund të nënkuptojë që dronët me një rotor ndonjëherë mund të kushtojnë më shumë se homologët e tyre. Për më tepër, tehet më të mëdha të rotorit nënkuptojnë një shans më të lartë për t'ju lënduar aksidentalisht.

Për më tepër, dronët shpesh nuk janë aq të qëndrueshëm, dhe ndërkohë që ende mund të fluturojnë mbi zona, ato gjithashtu mund të jenë më të vështirë për t'u fluturuar sesa dronët që kanë rotorë të shumtë për t'i mbajtur ata të ekuilibruar dhe në ajër. Ato mund të kushtojnë diku nga 25 mijë dollarë deri në 300 mijë dollarë.

2. Dronët me shumë helika “DJI Phantom”



Aty ku një dron me një rotor duket si një helikopter dhe është në gjendje të mbajë fluturimin me një rotor të vetëm, këto njësi kanë disa rotorë të pozicionuar në pika strategjike të anijes. Këta rrotullues shtesë mund ta bëjnë më të lehtë për dronin, të ruajë ekuilibrin dhe të vazhdojë të rrijë pezull.

Sidoqoftë, kur bëhet fjalë për lloje të ndryshme të dronëve komerciale, si një rregull i përgjithshëm, sa më shumë rrotullues të shtoni, aq më pak kohë anija do të jetë në gjendje të qëndrojë në ajër. Si të tilla, ndërkohë që këto njësi ofrojnë stabilitet të mirë, ato shpesh mbarojnë në gjysmë ore kohë fluturimi.

Për më tepër, shumica e dronëve me shumë rotorë nuk janë në gjendje të mbajnë një ngarkesë të rëndë, pasi kjo do të prishte ekuilibrin e mbajtur nga rotorët e tij kompensues. Çmimi ndryshon shumë, nga 5 mijë dollarë për njësitë fillestare në 65 mijë dollarë për opsionet kryesore.

3. Dronët me krahë të fiksuar



“Boeing Scan Eagle”, mjet ajror pa pilot

Mungesa e rotorëve dhe stili me krahë të fiksuar i këtyre dronëve, i bën ata më të ngjashëm me aeroplanët e kontrollueshëm sesa me stilin e helikopterëve të dronëve të tjerë. Në vend të rotorëve, krahët e tyre ofrojnë ngritje vertikale, që do të thotë se atyre u nevojitet vetëm energji e mjaftueshme për të vazhduar përpara, duke i bërë ata dronë idealë me rreze të gjatë.

Disa dronë me krahë të fiksuar mund të jenë me energji gazi. Aty ku njësitë me shumë rotorë nuk mund të qëndrojnë gjatë në ajër, një dron me krahë të fiksuar mund të qëndrojë në ajër për 16 orë fluturim të vazhdueshëm. Megjithatë, ata nuk janë në gjendje të fluturojnë ashtu siç mundën dronët me rotorë të stilit helikopter.

Mungesa e një rotorit gjithashtu e bën më të vështirë uljen e tyre. Ata duhet të futen me shumë kujdes për një “ulje në bark” jashtëzakonisht të butë dhe në duar jo eksperte, kjo ulje mund të shkojë keq shumë shpejt. Këto lloj dronësh zakonisht kushtojnë midis 25 mijë dhe 120 mijë dollarë.

4. Dronë hibridë me krahë të fiksuar



“VTOL UAV” prototip i NASA-s

Ky lloj droni përpiqet të marrë më të mirën nga dizajnet me krahë të fiksuar dhe me rotor, duke krijuar dronë që i përmbajnë të dyja. Një dron hibrid me krahë të fiksuar ka disa rotorë të bashkangjitur në skajet e krahëve të palëvizshëm.

Shumë prej këtyre dronëve në fakt bazohen në dizajnet e avionëve, që kanë ekzistuar që nga vitet 1950 dhe 1960. Sidoqoftë, teknologjia për t'i sjellë ato në jetë u konsiderua shumë e vështirë dhe ato u lanë, sidomos para shfaqjes së dronëve. Këto njësi janë ende mjaft eksperimentale, dhe kështu janë shumë më pak të disponueshme në treg sesa homologët e tyre me një rotor, me shumë rotorë dhe me krahë të fiksuar. Megjithatë, me disa kompani që i zhvillojnë ato, ato mund të jenë vala e së ardhmes.

5. Dronët e vegjël



“DJI Mavic Pro” është një dron i palosshëm

Në krahasim me katër llojet e para të dronëve të listuar këtu, të cilët të gjithë mund të kushtojnë lehtësisht dhjetëra apo edhe qindra mijëra dollarë, këto prirjen të kushtojnë deri në vetëm 100 dollarë. “I vogël”, në këtë kontekst zakonisht nënkupton midis 50.8 dhe 203.2 cm të gjatë.

Këta dronë janë repretësisht rekreativë dhe zakonisht nuk mund të kryejnë shumë nga funksionet komerciale për të cilat janë të aftë disa nga modelet e tjera. Për shembull, kur montohen siç duhet, kamerat në bord me shumë rotor, shumë të qëndrueshëm mund të kapin foto dhe video mahnitëse ajrore.

Në të kundërt, dronët e vegjël zakonisht janë shumë të lehtë dhe nuk kanë stabilitetin e nevojshëm për ekuilibrin e përsosur të fotografisë që kërkohet për marrjen e saktë të fotografive. Megjithatë, këto opsione mund të jenë një hyrje e madhe e lirë në botën e dronëve për amatorët dhe fëmijët.

6. Mikro dronët “Mikro dron”

Ndërsa dronët më të vegjël mund të nënkuptojnë rekreacion në sytë e konsumatorëve, për ushtarakët përdorimi i mikro dronëve është shumë profesional dhe i domosdoshëm. Shembulli më i njohur i këtij lloji droni në veprim sot është Black Hornet, i prodhuar për ushtrinë britanike.



NGA KOLANA E LIBRIT "OFICERET SHQIPTARE NË RRJEDHËN E HISTORISË"

Gratë ushtarake, monument i emancipimit të shoqërisë shqiptare

"Vajza me mendje inteligjente, gruaja me karakter të fortë dhe zonja me klas"

Kolonele Suzana Jahollari, "Doktore e shkencave", është një nga oficeret madhore të Shqipërisë, pas daljes në rezervë, drejtoi disa vite Prefekturën e Qarkut të Tiranës. Ashtu si dhe në detyrat e larta që ka kryer në strukturat e Forcave të Armatosura, edhe në këtë detyrë, ajo ka arritur tregues evidentë dhe është shembull i përkushtimit në punë dhe kompetencë në përm-bushjen e detyrave të ngarkuara. Për këtë, ajo është vlerësuar nga Këshilli i Ministrave dhe nga faktorë të tjerë vendas dhe të huaj. Suzana është modeli më i mirë i karakterit dhe përkushtimit të oficerëve shqiptarë, që kanë treguar se janë të afta e të përm-bushin me sukses të gjitha detyrat e ngarkuara, të çfarëdo rangu qofshin ato.

"Doktore e shkencave", Suzana Jahollari, oficerë madhore e ushtrisë shqiptare, ishte ndër të parat vajza me uniformë që fitoi gradën "Kolonele" në ushtri dhe njëkohësisht ndër të paktat që i janë besuar detyra të rëndësishme në strukturat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Ajo ka qenë ndër kohë dhe pedagoge në Akademinë Ushtarake "Skënderbej" si dhe autore e librave e studimeve shkencore në fushën ushtarake, pjesëmarrëse dhe lektore në shumë aktivitete ndërkombëtare të NATO-s etj... Njëkohësisht, ajo ka qenë dhe mbetet një intelektuale e formuar, me interesa e kontribut të dukshëm në interes të shoqërisë e vendit. Prej dy vitesh, ajo ishte prefekte e Qarkut të Tiranës, duke reflektuar një performancë të jashtëzakonshme në përm-bushjen e detyrave. Arritjet e saj, janë bërë dhe objekt eksperience nga kolegë e funksionarë të tjerë shtetërorë në detyra të ndryshme. Me këto arritje në një funksion tejet të rëndësishëm, ajo mbetet shembulli më i mirë dhe dinjitoz i përfaqësimit të suksesshëm të grave ushtarake jo vetëm në fushën e mbrojtjes e sigurisë, por dhe të qeverisjes.

Suzana Jahollari mban gradën shkencore "Doktor". Në momentin e lirim (01.10.2014) ka qenë pedagoge e Sociologjisë Politike në Departamentin e Lidershipit & Shkencave Shoqërore, në Akademinë e Forcave të Armatosura; Ka përfunduar Shkollën e Mesme të Përgjithshme "Dhaskal Todri" në Elbasan; Ka studiuar në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve, Specialiteti Gjitharmësh; Akademinë e Mbrojtjes "Spiro Moisiu", Kursin e Shtabit të Përgjithshëm; Programin Ekzekutiv të Studimeve të Avancuara të Sigurisë në Qendrën Europiane të Studimeve të Sigurisë "George C. Marshall", Gjermani (performancë e shkëlqyer); Qendrën e Trajnimit Ushtarak, Kanada, STANAG 6001(2); Kolegjin Rajonal të Mbrojtjes në Akademinë e Mbrojtjes.

Përvoja profesionale: Pedagoge e Sociologjisë Politike në Departamentin e Lidershipit & Shkencave Shoqërore, në Akademinë e Forcave të Armatosura; Komandante e Akademisë së Nënoficerëve "Thomson"; Drejtore e Drejtorisë së Inspektimit të Përgjithshëm në Ministrinë e Mbrojtjes; Shefe e Sektorit të Rekrutimit në Qendrën e Personel Rekrutimit; Shefe e Sektorit të Rekrutimit në Drejtorinë e Personel-Organizimit në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura; Shefe e Degës së Planifikimit Ushtarak në Komandën e Forcave Tokësore; Shefe e Degës së Personel-Organizimit në Komandën e Doktrinës e Stërvitjes; Shefe e Degës së Personel-Organizimit në Br. Zbulimit Elektronik; Shefe evidence, specialiste rekrutimi në DM Rrethit dhe DM Bashkisë Tiranë; Instrukto e Sektorin e Përgjithshëm në MM; Komandante kompanie në Shkollën e Mesme Ushtarake "Skënderbej"; Lektore e jashtme në Universitetin Ushtarak "Skënderbej" në vitin akademik "Lidershipi, vlerat morale të tij, teoritë mbi lidershipin";



Lektore e jashtme në vitin akademik në Akademinë e Mbrojtjes në Departamentin e Udhëheqjes Ushtarake dhe të Menaxhimit të Mbrojtjes. Nga



1 shkurti 2011 gjithashtu në krye të Shoqatës së Grave në Forcat e Armatosura Shqiptare për implementimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, "Për gratë, paqen dhe sigurinë". Përfaqësuese për dy vjet rresht, maj 2011, maj 2012, si delegate kombëtare në Konferencën vjetore të Komitetit të Perspektivës Gjinore të NATO-s në Shtabin e NATO-s në Bruksel dhe referuese në emër të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë për problemet gjinore

Zgjedhur me rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë së Shtetit Shqiptar në ciklin e emisioneve "UNIK" me fokus portretet e 100 femrave shqiptare të shquara për aktivitetin social në vitin e 100-të të Republikës së Shqipërisë, shquar për kontributin për barazinë gjinore në Forcat e Armatosura. Lektore në Konferencën për rolin, menaxhimin e funksionimin e sistemit rezervist në vendet e NATO-s, në tetor 2011 në Tiranë dhe në tetor 2012 në Selanik, Greqi. Drejtuese Paneli e referuese në Konferencën në Stockholm-it, prill 2011, "Për integrimin gjinor në sektorin e sigurisë e mbrojtjes dhe roli i problemeve gjinore në transformimin e mbrojtjes, organizuar nga Konsorciumi i Akademive të Mbrojtjes e Institutet e Studimeve të Sigurisë e Mbrojtjes si dhe Qendra e Kontrollit Demokratik të Forcave të Armatosura në Gjenevë. Drejtuese Paneli e referuese në Konferencën shkencore të organizuar nga Shoqata e Atlantikut në bashkëpunim me MJ në Athinë, Greqi, dhjetor 2012. Lektore në Konferencën për rolin, menaxhimin e funksionimin e sistemit

rezervist në vendet e NATO-s, në tetor 2013 në Bukuresht, Rumania me temë "What kind of reserve forces will Albania need in the future". Lektore në Konferencën "Crisis management models and CIMIC, për rolin, menaxhimin e funksionimin e sistemit rezervist në vendet e NATO-s, në tetor 2014 në Opatija, Rjeka, Kroaci me temë: CIMIC "The role of the NGO in civil-military relations with focus on reserve forces".

Kualifikimi: Studime në nivelin e tretë të

Doktoraturës 2010-2013, vazhdim, në Departamentin e Udhëheqjes Ushtarake dhe të Menaxhimit të Mbrojtjes, në Akademinë e Forcave të Armatosura; Akademia e lidershipit, "fuqizimi i gruas në vendimmarrje", 1 vit në Fakultetin e Filologjisë, Tiranë, organizuar nga Instituti për Demokraci në Washington, 2011-2012; Kurse e seminare, konferenca brenda e jashtë vendit për problemet e burimeve njerëzore, personelit, organizimit, planifikimit, rekrutimit, arsimimit, rezervistëve, barazisë gjinore, në SHBA, Angli, Itali, Austri, Gjermani, Bruksel, Turqi, Kroaci, Kanada, Greqi, Suedi, etj.; Kurs për menaxhimin e burimeve njerëzore dhe logjistikën në Institutin e Mbrojtjes në Holandë; Kursi i Filozofisë, 2-vjeçar.

Në fushën e botimeve evidenton: "Lidershipi, vlerat morale të tij, teoritë mbi lidershipin", botuar nga Qendra e Shtypit, Botimeve dhe Përkthimeve, viti 2006 në "Tekst mësimor i shkencave Ushtarake"; "Roli i faktorit moral në vendimmarrje", Revista Mbrojtja, dhjetor 2008, Organ i Ministrisë së Mbrojtjes; "Historia e betejës së Vaterlosë", Revista Mbrojtja, qershor 2009; "Konceptet e sistemet e drejtimit të inspektimit të përgjithshëm", Revista Mbrojtja, korrik 2009; "Integrimi i perspektivës gjinore si një pjesë natyrale e organizatave ushtarake dhe operacioneve ndërkombëtare", në revistën teoriko-shkencore të Komandës së Doktrinës e Stërvitjes, qershor 2011; "Information age: Toward Cyber terrorism", botuar në revistën periodike teoriko-shkencore "The Heritage", të Universitetit Ndërkombëtar të Strugës, Nr. 6, 2011; "Gender and Defence Transformation", botuar Conference Report, Stockholm, 18-20 prill 2011, "Transforming national structures, sustaining international operations", në Akademinë e Mbrojtjes Suedeze në Stockholm; "Lidershipi dhe roli i tij në procesin krijues", revista teoriko-shkencore e Universitetit Ndërkombëtar të Strugës, 2011; "Edukimi për paqen, rruga për forcimin e sigurisë në rajonin euro-atlantik", botuar Conference Report, Brussels, September 2011; "How can gender make a difference to security", botuar Conference Report, NATO HQ Brussels, 22-25 maj 2012 "Effects of armed conflicts to a society"; "Reserve and roster concept in the Albanian Armed Forces", botuar në Conference Report, Greece, tetor 2012; "Koncepti i perspektivës gjinore në FA në këndvështrimin social", lektim në Konferencën shkencore të organizuar nga Shoqata e Atlantikut në bashkëpunim me MJ në Athinë, Greqi, dhjetor 2012; "Reserve officers role in building and maintaining globale peace", lektim në, Rumania, Bukuresht, tetor, 2013; "Ushtarakët në rezervë dhe roli i tyre si simbol i paqes", botuar në revistën teoriko-shkencore të Komandës së Doktrinës e Stërvitjes, dhjetor 2012; "Gjinia dhe roli i saj në procesin e vendimmarrjes në operacionet në mbështetje të paqes", botuar në revistën teoriko-shkencore të ISIS, Instituti i Studimeve të Inteligjencës dhe Sigurisë, mars 2013; "Dimensioni i shkencave shoqërore në formimin e lidershipit në Forcat e Armatosura, botuar në revistën teoriko-shkencore të Akademisë së FA-së "55 vjet AFA, 10 maj 1958-10 maj 2013", maj 2013; "Roli i lidershipit në kuptimin e zbatimit e procesit gjinor në FA", botuar në revistën teoriko-shkencore të Komandës së Doktrinës e Stërvitjes, shtator 2013, etj. Njohëse e mirë e gjuhës angleze dhe ruse.



Kjo ditë na bën ta kthejmë kokën pas jo vetëm për t' i kujtuar ata që nuk janë në mesin tonë, por edhe për ta thënë fuqishëm se për ta nuk është vetëm një ditë si kjo, por çdo ditë. Me kujtimin për ta, do të bëjmë çdo ditë përpjekje që pritja e familjeve të marrë fund”, -ka theksuar Osmani, sipas një komunikate nga Presidenca.



Osmani: Të zhdukurit me dhunë janë thirrja jonë për drejtësi

Në Ditën Kombëtare të Pagjeturve, që përkon me datën e Masakrës së Mejës, Osmani ka thënë se dita është përkujtim, pritje e ankth për familjarët dhe shtetin e Kosovës.

“Janë mbi 1600 të zhdukur me dhunë, thirrja jonë për drejtësi, e cila do të vihet në vend kur para saj do të dalin autorët e krimeve dhe do të zbardhet fati i secilit nga njerëzit tanë. Duam dhe do të insistojmë të dimë për fatin e tyre. Kjo ditë na bën ta kthejmë kokën pas jo vetëm për t' i kujtuar ata që nuk janë në mesin tonë, por edhe për ta thënë fuqishëm se për ta nuk është vetëm një ditë si kjo, por çdo ditë. Me kujtimin për ta, do të bëjmë çdo ditë përpjekje që pritja e familjeve të marrë fund”, -ka theksuar Osmani, sipas një komunikate nga Presidenca.

“Synimi i regjimit gjenocidial serb ishte spastrimi etnik, ndaj aksioni kriminal u shtri në 15 fshatra të Rekës së Keqe dhe Luginës së Çarragojës në Gjakovë. Meja është dhimbje e madhe e Kosovës dhe ndër rrëfimet më të përgjakshme të luftës. Nuk do ta harrojmë kurrë, sepse vetëm kështoj do ta dimë vlerën e lirisë dhe shtetit. Do t' i kujtojmë përherë martirët e Mejës, duke u angazhuar vazhdimisht që autorët të vihen para drejtësisë”, -ka thënë Osmani në përkujtimin e



Masakrës së Mejës.

Para 23-vjetësh, më 27 prill 1999, forcat serbe rrethuan Rekën e Keqe dhe Lugun e Carragojës në rrethinën e Gjakovës. Në një operacion të planifikuar, u ndërpre në gjitha rrugët duke lënë të hapura vetëm dy në drejtim të

Mejës. Grumbullimi i meshkujve në grupe filloi në mëngjes, në një bilanc të tmerrshëm që goditi 15 fshatra të rrethit të Gjakovës. U ekzekutuan 376 persona, në një prej masakrave më të mëdha në Kosovë. Të vrarë në këtë masakër mbetën djemtë e burrat në

grupe nga moshja 15-60 vjeç. Atë ditë asnjëri nga të ndalurit nuk arriti të dilte i gjallë nga Meja dhe pas luftës disa prej trupave të masakruar të tyre u gjetën nëpër varreza masive nëpër Kosovë kurse të tjerët ka informacion se janë ende diku nëpër Serbi.

RAPORTI
Parlamenti, sipas draftit të këtij raporti, shpreh keqardhje për suksesin e kufizuar të nismave për të përfshirë komunitetin serb të Kosovës në strukturat politike, sociale dhe ekonomike. Ndërkaq, rikujton se institucionalizimi dhe mësimi i gjuhëve zyrtare në Kosovë dhe qasja e barabartë në shërbime dhe informacione në gjuhët zyrtare, është esenciale.

Bashkëpunimi

Gratë Ukrainase stërviten në Kosovë për të ç'aktivizuar minat

Ndërsa fokusi i luftës së Rusisë në Ukrainë po zhvendoset në lindje, forcat ruse po mbushin terrenin me mina tokësore.

Gjashtë gra ukrainase kanë filluar trajnimin në Kosovë për të çaktivizuar mjetet shpërthyes në vendin e tyre të shkatërruar nga lufta. Ato janë grupi i parë i çminuesve ukrainase që po stërviten nga qendra MAT Kosova, në qytetin e Pejës.

Instruktorët po u mësojnë gjashtë grave ukrainase se si të asgjësojnë municionet e pashpërthyer, të tilla si bombat thërrmuese, fushat e minuara dhe mbetje të tjera shpërthyes. 20-vjeçarja Anastasiia Minchukova thotë se iu bashkua trajnimit për të ndihmuar vendin e saj.

“Në Ukrainë ka një kërkesë të madhe për njerëz që dinë të bëjnë çminimin, sepse lufta do të përfundojë së shpejti. Ne besojmë se ka shumë punë për të bërë dhe them se do të jem e dobishme të ndihmoj”.



Anastasiia thotë se i mungon jeta normale që kishte jo shumë kohë më parë.

“Çfarë më mungon? Paqja.

Ëndërroj për paqen, për të fjetur në shtratin tim pa u shqetësuar se do të shkoj në strehimore për bomba gjatë gjithë kohës. Më mungojnë njerëzit që

humba. Po, jeta normale tek e cila nuk do të mund të kthehem më kurrë”.

Në Kosovë pati mjete të shumta të pashpërthyer të mbetura pas luftës në vitin 1999, derisa OKB-ja e shpalli të sigurt nga minat në vitin 2001. Sukseset e shpejtë në pastrimin e minave ka ndihmuar në krijimin e reputacionit të

Kosovës si një vend i mirë për trajnime. Instruktori Artur Tigani i ka ende të freskëta plagët e luftës.

“Lufta është ende e freskët në kujtimet tona, edhe pse kanë kaluar gati 23 vjet. Janë ende të freskëta në kujtimet tona, vështirësitë që ndeshëm kur filluam pastrimin e minave në

Kosovë. Kështu që qendra e trajnimit është ndërtuar mbi përvojën tonë të drejtpërdrejtë”.

38 vjeçarja Yuliia Katelik është nënë e tre fëmijëve nga Kramatorsku:

“Si nënë e kuptoj që ka një problem me minat që është mjaft serioz sidomos për fëmijët. Ne përballemi me një përqendrim të lartë të përhapjes së llojeve të ndryshme të mjeteve shpërthyes dhe duhet të punojmë për sigurinë dhe mirëqenien e fëmijëve dhe të të gjithë njerëzve”.

Ekspertët thonë se trupat ruse kanë shpërndarë mina të shumta pas tërheqjes së tyre nga veriu i Ukrainës tani që po përqendrohen në lindje, duke përfshirë variante me sensorë që ndjeshëm që mund të shpërthejnë nëse dikush u afrohet, edhe pa i prekur. Fakti që shumë prej tyre janë vendosur pa dallim rreth zonave të populluara është dëshmi, thonë vëzhguesit, e qëllimit të Moskës për të shkatërruar shtatërrim dhe për të mbjellë frikë.

Filozofia e Lidhjes ishte e ndryshme me atë çfarë njerëzimi kishte bërë ndër shekuj. Ajo nuk do të kishte ushtri, prandaj mbetej të mbështetej tek forca e armëve e Fuqive të Mëdha, në mënyrë që të detyronte zbatimin e rezolutave të saj, të impononte sanksione ekonomike në raste të caktuara ose të mobilizonte forca ushtarake po ta kërkonin interesat e përgjithshme.



Lidhja e Kombeve, si një organizatë ndërkombëtare erdhi fill pas Konferencës së Paqes të Parisit në vitet 1919–1920. Qëllimi i kësaj Lidhjeje ishte çarmatimi dhe parandalimi i luftërave bazuar në një siguri të përbashkët. Grindjet midis vendeve të ndryshme do të zgjidheshin nëpërmjet bisedimeve, mjeteve diplomatike dhe përmirësimit të mirëqenies globale. Filozofia e Lidhjes ishte e ndryshme me atë çfarë njerëzimi kishte bërë ndër shekuj. Ajo nuk do të kishte ushtri, prandaj mbetej të mbështetej tek forca e armëve e Fuqive të Mëdha, në mënyrë që të detyronte zbatimin e rezolutave të saj, të impononte sanksione ekonomike në raste të caktuara ose të mobilizonte forca ushtarake po ta kërkonin interesat e përgjithshme.

Çështje të tjera si kjo dhe traktate në lidhje me këtë duke përfshirë kushtet e punës, trajtimin e drejtë të banorëve vendas, trafikimi njerëzor dhe i drogës, tregtia e armëve, shëndeti global, robërit e luftës, dhe mbrojtja e pakicave në Europë. Në zgjerimin e saj më të madh nga 28 shtatori 1934 deri më 23 shkurt 1935, ajo kishte 58 shtete anëtare.

Lidhja e kombeve u krijua më 10 janar të vitit 1920. Plani prej 14 pikash, i Woodrow Wilson, propozuar në Konferencën e Paqes së Versajës, kërkonte formimin e një organizate ndërkombëtare që të mund të mbronte si kombet e mëdha ashtu edhe kombet e vegjël.

Ajo duhet të punonte në zgjidhjen paqësore të konflikteve botërore. Të mëdhenjtë e Konferencës së Paqes e aprovuan planin e tij. Qendra e Lidhjes u vendos në Gjenevë të Zvicrës, pasi Zvicra ishte një vend neutral. Organet kryesore të Lidhjes ishin: Asambleja, ku bënin pjesë gjithë anëtarët e Lidhjes; Këshilli, i përbërë nga pesë anëtarët e përhershëm dhe katër anëtarët e radhës; Gjykata ndërkombëtare e Drejtësisë.

Gjermania dhe Rusia nuk u bënë anëtare të Lidhjes së Kombeve. SHBA-të propozuan krijimin e Lidhjes por nuk u bënë anëtarë të saj. SHBA-ja për këtë arsye, nuk mundi të luajë asnjë rol në mbështetje të veprimtarisë së Lidhjes. Dy anëtarët më të rëndësishëm ishin Britania dhe Franca, të cilët u përpoqën pa shume sukses të mbështesin veprimtarinë e Lidhjes. Të dy kishin vuajtur shumë gjatë luftës dhe nuk ishin entuziastë për t'u përfshirë në veprimtarinë e Lidhjes.

Krijimi i Lidhjes ishte i rëndësishëm. Ajo ishte një shpresë për forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe për të siguruar një paqe afatgjatë.

Gjuhët zyrtare të Lidhjes së Kombeve ishin Frëngjisht dhe Anglisht. Lidhja refuzoi adoptimin e Esperantos si gjuhë pune. Kina dhe Japonia e donin Esperanton, por Franca kundërshtoi fuqishëm. Në vitin 1939, një emblemë zyrtare për Lidhjen e Kombeve doli: dy yje me pesë cepa brenda një pesëkëndëshi blu. Ata simbolizuan pesë kontinentet e Tokës. Në një hark në krye shfaqet emri anglisht "League of Nations", ndërsa në një tjetër në fund tregohet

Lidhja e Kombeve dhe Shqipëria në rrugëtimin shekullor të saj



në Frëngjisht "Société des Nations",

Për të ardhur deri tek anëtarësia e vendit tonë në Lidhjen e Kombeve duhej të ishin patjetër në mbështetje Britania e Madhe dhe SHBA-të. Ndërsa Eduard Grey e kishte treguar interesin e tij për Shqipërinë në Konferencën e Ambasadorëve të vitit 1913, në Londër, do të duhej Presidenti Amerikan Wilson që të sigurote ekzistencën e shtetit tonë në Konferencën e Paqes në Paris, 1919. Në këtë akt, rol të rëndësishëm kanë luajtur Vatanët e Amerikës nëpërmjet delegatit të tyre në Konferencë, Reverend Charles Telford Erickson-i, pjesë e delegacionit shqiptar të kryesuar nga Turhan Pasha. Kjo jo vetëm do të ruante kufijtë e 1913-ës, por do të hapte rrugën për anëtarësimin e Shqipërisë në Lidhje. Për pranimin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve kanë ndikuar dy elementë shumë të fuqishëm:

- Presidenti Wilson, i cili e mbrojti Shqipërinë në Paris, duke e shpëtuar nga copëtimi që i kishte rezervuar Traktati i Fshehtë i Londrës i vitit 1915;

- Lobimi i fuqishëm i anglezit Aubrey Herbert, me delegacionin britanik të përbërë ose alternuar prej Lordit Robert Cecil, Lordi Balfour dhe historianit M. Fisher.

Kështu veprimi i parë e ndihmoi të dytin. Shqipëria paraqiti kërkesën për anëtarësi në dhjetor të vitit 1920. Raportin e nënkomisionit për paraqitjen e kërkesës së Shqipërisë, e mbajti Lordi Robert Cecil, përfaqësues i Mbretërisë së Bashkuar, mik i afërt i Aubrey Herbert-it. Ai në argumentet e veta rreth Shqipërisë tha se, ndonëse kufijtë e Shqipërisë ende nuk janë përcaktuar përfundimisht, fakti që vendi ekziston prej disa vitesh brenda këtyre kufijve, e vërteton ekzistencën e tij si shtet. Ndonjë rregullim i mëtejshëm mund t'i lihej së ardhmes. Lordi Cecil tha se Shqipëria duhej pranuar pasi:

"Ajo prej virtutit përbënte një komb me dëshirë të njëzëshme të banorëve të vet".

Ajo çfarë Lordi Robert Cecil kërkoi në Asamblesë e Lidhjes së Kombeve nuk

gjeti përkrahje për shkak të lakmive të fqinjëve dhe shteteve që i mbështesnin ata. Megjithatë, ai lëshoi një apel të fuqishëm për anëtarësimin e Shqipërisë, i cili pati një efekt të jashtëzakonshëm. Në fjalën e tij ai deklaroi:

"Njohja fillimisht e sjell shtetin e ri në familjen e kombeve e më pas, ai vazhdon të ekzistojë që mos të zhduket prej ndonjë pushtimi apo ndonjë marrëveshjeje të përgjithshme të atyre që e lakmojnë atë; Qeveritë herë pas here ose i arrijnë qëllimet, ose dështojnë t'i arrijnë, por kur ekziston shteti si shtet, ai mbetet."

Falë kësaj këmbënguljeje të Lordit Robert Cecil në Komisionin e Pestë të Asamblesë u deklarua si më poshtë:

"Në tërësi ne jemi të mendimit se megjithëse Qeveria e Shqipërisë nuk është tërësisht në pozitën që i takon, prapëseprapë ajo është një qeveri e cila ka një shkallë të caktuar autoriteti në të gjitha pjesët e vendit dhe padyshim përfaqëson një ndjenjë shumë të fortë kombëtare, e cila shpërfill dallimet fetare.

Duket gjithashtu se vendi është i banuar prej një race të pastër shqiptare që flet një gjuhë të përbashkët, atë shqipe."

Argumentet e Lordit Cecil, si dhe puna e delegacionit shqiptar dhe veçanërisht paraqitja e çështjes shqiptare nga Fan Noli, bënë që Shqipëria të pranohet në Lidhjen e Kombeve më datën 17 dhjetor 1920. Ai në mënyrë të veçantë theksoi faktin se:

"Kufijtë e Shqipërisë ishin po ata të caktuar nga Konferenca e Ambasadorëve dhe ajo konferencë nuk ishte abroguar. Ai theksoi faktin se shqiptarët ishin në zotërim të tërë territoreve, përveç një zone në Korçën e liruara nga francezët dhe pushtuar nga grekët.

Në ndihmë të Shqipërisë nga delegacioni britanik doli edhe Mr. H. A. L. Fisher, i cili mbështeti fort ruajtjen e integritetit të Shqipërisë dhe gjeti argumente shumë të forta ligjore ndërkombëtare, se përse Lidhja e Kombeve dhe Konferenca e Ambasadorëve, si dy trupa ndërkombëtarë nuk duhet të ndërthureshin në veprimtarinë e tyre në çështjet e kufijve të Shqipërisë, siç kërkonin fqinjët lakmtarë të vendit tonë. Ai deklaroi tekstualisht:

"Këshilli i Lidhjes së Kombeve e vlerëson si të pakëshillueshëm që të merret njëherësh me të njëjtën çështje".

Ai shtoi se marrëveshja midis shteteve anëtare e përjashtonte ipso facto marrjen me çështjen e kufijve të Shqipërisë nga ana e Lidhjes së Kombeve.

Më 4 korrik 1921, Kryeministri shqiptar Vroni, paraqiti në Asamblesë e Lidhjes një apel ku i kërkonte Lidhjes të mos njihte asnjë shmangie nga kufijtë e caktuar prej Konferencës së Ambasadorëve të vitit 1913. Më datën 2 shtator 1921, u miratua një raport i përgatitur prej Lordit Balfour, ish-Sekretar i Jashtëm i Britanisë dhe një ndër arkitektët e Lidhjes së Kombeve.

Ai i doli zot Shqipërisë, duke e përmbledhur në tri fraza të përgjithshme tërë thelbin e kësaj çështjeje. Andaj ai udhëzoi:

- Asamblesë t'i kërkohej nga Shqipëria që të vepronte për përcaktimin e kufijve, ndërsa Këshilli të ndalonte dhunimin e tyre;

- Çështja e statusit të Shqipërisë të zgjidhej përfundimisht me pranimin e saj në Lidhjen e Kombeve;

- Trajtimi i pakicave rridhte jo nga Traktati i Paqes, por nga Rezoluta e Asamblesë së Lidhjes.

Këto ide të Lordit Balfour u pranuan dhe kjo pati një ndikim shumë të madh në mbarëvajtjen e punëve të më pastajme të Shqipërisë.

Më 4 tetor, në komisionin e gjashtë të Lidhjes, u paraqit një rezolutë prej Lordit të Afrikës së Jugut, Robert Cecil për kufijtë, e cila pas shumë debatesh, pas kuintave, kaloi e plotë duke i bërë një shërbim tjetër të madh çështjes shqiptare. Një kombinim i britanikëve Balfour – Fisher – Cecil nën ndikimin e kolonelit Aubrey Herbert, në Lidhjen e Kombeve, zgjidhi shumë probleme që nxirrnin herë grekët, herë jugosllavët, e herë italianët në forma të ndryshme, sa për pretendime territoriale, ashtu edhe për trajtim të pakicave.

Kështu u ra dakord për dhënien e shtetësisë çdo banori të Shqipërisë që kishte mbi dy vjet që jetonte aty pa dallim feje apo etnie. Po kështu lejohej përdorimi i çfarëdolloj gjuhe, por shqipja do të ishte gjuha zyrtare. Gjuha amtare sigurohej të përdorej në gjykata dhe fëmijët e minoriteteve të mësonin gjuhën e nënës së tyre.

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

Disa dukuri të Luftës së Shkodrës, 1912-1913

Shkodra, një nyjë e fortë

Shtetet e reja ballkanike, pas lidhjes së Aleancës mes tyre, në pranverën e vitit 1912, synonin të përfitonin nga turbullira që shkaktoi në Kostandinopojë disfata në luftën italo-turke në 1911 dhe nga kryengritjet e herëpashershme të shqiptarëve, veçanërisht, viti 1911. Sikurse shkruan historiani Ferdinand Schevill: “Ata e ndjenë fitoren shqiptare, tashmë të pashmangshme, nëpërmjet të cilës Shqipëria ishte duke u ndërtuar si një shtet autonom i përbërë nga katër vilajete: i Shkodrës, Janinës, Manastirit dhe Kosovës. Në qoftë se propozimi shqiptar do të pranohet, secili prej katër aleatëve, Serbia, Mali i Zi, Greqia dhe Bullgaria do ta shikonte derën e mbyllur në një krahinë të caktuar, të cilën secila në mënyrë të veçantë lakmonte”.

Më 12 tetor 1912 shpërtheu Lufta e Parë Ballkanike. Brenda një periudhe të shkurtër, shtetet e reja të Ballkanit e dërrmuan Perandorinë Osmane. Lufta Ballkanike e vitit 1912 erdhi në mënyrë të papritur në botën e trazuar të para Luftës së Parë Botërore, mbasi Fuqitë e Mëdha nuk ishin të përgatitura për një fitore të shpejtë të aleatëve të vegjël para një perandorie. Por, siç shkruan Richard C. Hall: “fitorja ishte një fitore krejt e natyrshme, për shkak të përparimit kuptimplotë moral, ekonomik dhe ushtarak që kishin bërë shtetet e krishtera që prej çlirimit të tyre”. Në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, Austro-Hungaria argumentoi se përfshirja e Shkodrës ishte thelbësore për ekonominë e shtetit të ri shqiptar, duke kërkuar dhe mbrojtur gati e vetme, të drejtën e shtetit të ri shqiptar mbi një pjesë të madhe të Kosovës së sotme, përfshirë qytetet e Pejës, Gjakovës, Prizrenit dhe krahinën e Dibrës në tërësi, sepse, sipas saj, ekzistonin arsye racore dhe fetare për të mos ia dorëzuar këto qytete Malit të Zi dhe Serbisë. Rusia, njëlloj siç sillte sot pas 104 vitesh, nuk hapi rrugë për zgjidhjen e problemit të Shkodrës pa kënaqjen deri në fund të ambicieve të Serbisë në Shqipërinë Verilindore, gjegjësisht në Kosovë.

Për mbrojtjen e qytetit të Shkodrës ishin të interesuar si shqiptarët, ashtu edhe turqit. Shqiptarët do të mbronin Shkodrën nga një pushtues i ri, i cili donte të tjetërsonte qytetin dhe banorët, ndërsa turqit luftonin për dinjitetin e tyre ushtarak e kombëtar, për të mos rënë rob të serbo-malazezëve, si dhe për interesa politike dhe ushtarake të tyre. Është mjaft e trishtueshme sot, kur shikon se me çfarë lloj cinizmi, është ndarë truallit etnik shqiptar, si i janë shpëputur atij troje kompakte etnike, dhe si janë nënvlehtësuar në këtë ndarje kriteret më të domosdoshme etnografike dhe historike dhe se si është pranuar sovraniteti i shteteve të reja mbi territoret që Perandoria e kalbur Otomane kishte ceduar.

Në përgjigje të presionit gjerman për të mos prishur konferencën, Austro-Hungaria bëri një seri lëshimesh deri sa Rusia ra dakord në përfshirjen e Shkodrës në Shqipëri. Para një “nevoje” të tillë të konsideruar si parësore për Fuqitë, por shkatërrimtare për Shqipërinë, diplomacia britanike u mundua të luajë rolin e ndërmjetësit, rol i cili për mendimin tonë, e detyroi atë të heqë dorë nga disa parime themelore konstante pozitive ndaj çështjes shqiptare, të kristalizuara, sidomos në krizën shqiptare të vitit 1911, që e kishin bazën në erën e re që po frynte në diplomacinë britanike. Ndër ata do të dëshiroja të përmendja memorandumun e dërguar nga misionari amerikan Telford Erickson, Sir Edward Grey-t. Erickson pasi argumentoi me fakte dhe dokumente historike lashtësinë iliro-arbënore të shqiptarëve, pyet se “si mund të ndahet në mes kjo tokë antike dhe ky popull antik në mes aleatëve si një plaçkë lufte”? Më pas ai shtonte: “Ne Zotërinj kemi pas mësuar se drejtësia duhet të jetë guri themeltar i çdo rendi jetëgjatë në shoqërinë njerëzore”.

Mbrojtja e qytetit ishte bërë ndërkohë e famshme në Europë. Një korrespondent i gazetës angleze “Times”, i quajtur H. Nevinsin, botonte çdo javë nga një artikull dhe, bashkë me raportimet e kolegëve të tjerë, mbrojtja e qytetit bëri bujë në Perëndim. Për më tepër, Europa u sensibilizua nga njoftimet mbi bombardimet e bëra ndaj popullsisë civile dhe trupit diplomatik në Shkodër. Për të verifikuar raportet e gazetave dhe ato të konsujve të huaj atje, Konferenca e Ambasadorëve dërgoi në qytet një mision të kryesuar nga atashu ushtarak austriak në Cetinë, kapiteni Hubka. Hubka, që u takua me Hasan Riza Pashën dhe nën-komandantin Esat Pashë Toptanin, e kuptoi se qyteti po i afrohej pragut të urisë dhe se mbi të qenë hedhur bomba pa mëshirë. Në përgjigje të kësaj, parlamenti britanik zhvilloi një seance diskutimi për rrethimin e Shkodrës dhe ministri i Jashtëm Grey, u thirr për të dhënë shpjegime. Grey mbajti një fjalim të hapur, por edhe shumë cinik. “Ne e dimë, -tha ai, -se pas ca kohësh fëmijët tanë do ta shohin të gjithën këtë si një padrejtësi të madhe. Do të çuditën që toka të banuara kryesisht prej shqiptarësh ose krejtësisht prej shqiptarësh i janë dhënë fqinjëve të tyre. Kjo është e padrejtë, por ata do të kuptojnë se ekuilibri i Fuqive të Mëdha nuk mund të prishej për një vend të quajtur Shqipëri”. Grey nuk harroi të sqarojë, se lufta që Mali i Zi po bënte në Shkodër nuk ishte më një luftë çlirimtare, por një luftë e mirëfilltë pushtuese. Ai shtoi se kundër kësaj janë gjithë Fuqitë e Mëdha. Ismail Qemali ishte i shqetësuar për çështjen e Shkodrës. Ai kishte pasur gjithnjë frikë se qyteti mund të kapitullonte, para se qeveria e re e Shqipërisë ta shtinte në dorë, prandaj kishte vendosur të vinte gjithçka në lëvizje që Shkodra të mos binte nën pushtimin malazez. Për t'i



bërë presion Malit të Zi që të heqë rrethimin, disa luftanije austro-hungareze të shoqëruara nga anije italiane, angleze dhe franceze manifestuan në ujërat e Adriatikut, përballë Tivarit. Siç kishin bërë 40 vjet më parë kundër trupave të Haxhi Zekës që mbronin Ulqinin nga pushtimi malazez.

Roli dhe qëndrimi i banorëve të qytetit dhe i malësisë

Shpirti i gjallë i kulturës së re u bë nacionalizmi shqiptar, ideja e shqiptarizms, e formuluar nga Pashko Vasa në “marsejzen” shqiptare “Mori Shqypni, e mjera Shqypni”, tringëlloi e fuqishme dhe krenare në rreshtat e luftëtarëve, banorë të qytetit dhe malësisë në atë kohë. Pa këtë shpirt të gjallë të kulturës kombëtare, shkodrani e malësori, nuk mund të mbronin Shkodrën, të kuptonte gjendjen dhe rrezikun që i kanosej, të kuptonte përse mbrohej, ku mbështetej e përse luftonte. Lufta e Shkodrës zbuloi edhe një herë botën shqiptare me gjithë madhështinë dhe tragjizmin e historisë tonë. Kjo luftë zbuloi të kaluarën e lavdishme, dhimbjen, mjerimin, prapambetjen, aftësitë e popullit për të mos u përkulur, traditat, zakonet, psikologjinë e një populli luftëtar. Lufta e Shkodrës u zhvillua midis ushtrisë turke e vullnetarëve shqiptarë, nën komandën e Hasan Riza Pashës e më vonë të Esat Pashës dhe të ushtrisë serbo-malazeze. Një pjesë e malësorëve të Malësisë së Madhe, të shtrënguar të emigronin në Mal të Zi në kryengritjen e 1911-ës, kishte bërë kauzë të përbashkët me Malin e Zi dhe morën pjesë në luftë kundër ushtrisë turke. Por, malësorët nuk u përdorën si forcë goditëse për të çare shtigjet drejt Shkodrës prej malazezëve. Ata filluan sulmet dhe luftuan në shpinë të forcave malazeze. Në fortifikimin e Shkodrës një kontribut të madh dha dukshëm popullsia e qytetit. Ajo morri pjesë në transportimin e materialeve të fortifikimit në destinacion, ndërtimin e transheve, pikëmbështetjeve, hapjes së rrugëve të reja deri në majë të Taraboshit dhe në Bardhaj të Madh, si dhe në përmirësimin e atyre ekzistuese në Shtojë e Bërdicë. Por padyshim faktori më kryesor ishte vendosmëria e popullit të Shkodrës dhe vullnetarëve shqiptarë që luftonin për të mbrojtur atdheun e tyre. Qyteti i Shkodrës u mbrojti në radhë të parë, prej shqiptarëve, njerëz luftarakë, të rreptë, xhelozë për lirinë e tyre, krenarë për traditat e veta.

Roli i komandantit të garnizonit turk, Hasan Riza Pasha

Komandanti i ushtrisë turke Hasan Riza Pasha, një ushtar i dalluar i Shtatmadhorisë turke, ka qenë një ushtar i madh dhe i pajisur me të gjitha cilësitë e Njeriut të lartë e të mirë. Alush Lohja, mik personal i Hasan Riza Pashës, i thotë një ditë kapiten Xhemil Prizrenit, adjutant i Pashës: “Nga ana ime t’i thuash këto fjalë Hasan Riza Pashës, mbasi unë vetë nuk guxoj t’ia them. Pasi Turqia e humbi luftën, tash e tutje s’ka asnjë kuptim të luftohet nën flamurin e Turqisë në Shkodër”. Hasan Rizai i thotë Alush Lohjes: “Më vjen keq të flasim me ndërmjetësi duke qenë se jemi miq”. Me shtabin e tij, Hasan Riza Pasha, komandanti turk i qytetit, që vendosur në Bardhanjore dhe atë pasdite mbledhi të gjithë komandantët e tij. “Qyteti do të rrethohet së shpejti, iu tha ai atyre, por ky qytet nuk do të bjerë në dorë e malazezëve. Shkodra është fati ynë ose varri ynë, por jo turpi ynë. Sot kemi 5 mijë trupa ushtarake, por mbi 20 mijë të tjerë janë duke ardhur në ndihmën tonë.

Që sot fillon një betejë e vështirë, që asnjë nga ne nuk e di se sa do të zgjasë”. Në realizimin e këtij fortifikimi një rol të veçantë pati Komandanti i Shkodrës Hasan Riza Pasha, i cili ishte i njohur me përvojën gjermane në këtë fushë pasi kishte mbaruar një kurs Shtatmadhorie në Berlin. Sipas fjalëve të një gjenerali malazez Hasan Rizai “kishte punuar si japonez dhe ishte mbrojtur si një luan”. Vetë Hasan Rizai e çmonte shumë vlerën e këtij fortifikimi dhe sipas mendimit të tij malazezët nuk mund ta merrnin dot Shkodrën.

Shfaqja e dukurisë së dorëzimit të Shkodrës nga Esad Toptani. Në atë kohë situata në qytet ishte rënduar dhe ushqimet, me gjithë racionimin e fortë, nuk gjendeshin më. Kësaj i duhej shtuar fakti që pjesa më e madhe e qytetit ishte bërë gjermadhë nga bombardimet dhe në spitale nuk kishte më vend për të plagosurit-shumica e të cilëve ishin nga popullsia civile. Po kështu, trupat mbrojtëse kishin shumë humbje nga radhët e tyre, edhe pse tregimet e kohës dëshmojnë se edhe malazezët kishin shumë të vranë. Në qytet kishte filluar të qarkullonte ideja e dorëzimit, ide që sidoqoftë nuk thuhej me zë të lartë. Ndërkohë, gjendja në qytet ishte rënduar. Zija e bukës kishte pllakosur kudo dhe më shumë se gjysma e të vdekurve ditore ishin nga uria. Qyteti ishte shkatërruar dhe, sipas kronikave të kohës, vullnetarët nga Shqipëria e Mesme kishin filluar të zienin opingat e tyre prej lëkure dhe të pinin lëngun e tyre. Nga ana tjetër, vdekjet dhe plagët kishin provokuar epidemi, që po bëheshin gjithnjë e më kërcënuese. Më 5 Mars, princi Danilo kërkoi një armëpushim dyditor dhe ofroi një ndihmë për të plagosurit. I shoqëruar nga ministri i Jashtëm i Malit të Zi, ai mbërriti në qytet me anije dhe u tmerrua nga pamja që i hapej para syve. Në pak orët që qëndroi në qytet ai bisedoi vetëm për vetëm me Esat Pashën dhe tema kryesore duhet të ketë qenë: dorëzimi i qytetit. Nuk dihet se si shkoi kjo bisedë, por dihet se qyteti rezistoi pas kësaj edhe më shumë se një muaj e gjysmë. Nga Shkodra, kryekonsulli austro-hungarez, Zambaur, në nëntor të vitit 1912, njoftonte se Esad Pasha ishte gati t’ia dorëzonte Shkodrën Austro-Hungarisë, por Hasan Riza Pasha e kishte kundërshtuar këtë. Vrasja e turkut “me nënë shqiptare” që dëshironte të luftonte për mbrojtjen e Shkodrës deri në fund e të mos i dorëzohej ushtrisë malazeze, çoi në shitjen e Shkodrës prej Esat Pashës. Me të marrë vesh dorëzimin e Shkodrës, Ismail Qemali deklaroi...: Në qoftë se është e vërtetë se Esad Pasha e ka lëshuar Shkodrën me ushtri, armatim e topa, atëherë mund të vërtetohet tregtia që kanë bërë mbreti Nikolla dhe Esad Pasha.

Dorëzimi u bë mëngjesin e datës 25 prill dhe, vetëm pasi u largua edhe luftëtari i fundit shqiptar, pushtuesi ngriti në kalanë e Rozafës flamurin e vet. 25 Prilli ishte dita e 183 e rrethimit. 183 ditë që kishin shënuar mbi 3 500 të vranë e të vdekur, disa mijëra të plagosur apo të sëmurë si dhe një shkatërrim të mbi 60 % të qytetit. Por që i kishin siguruar Shkodrës një emër të madh në kronikat evropiane. Ushtria malazeze hyri në Shkodër 24 orë pasi qenë larguar trupat e Esat Pashës. Këto të fundit, duke kaluar nëpër Lezhë dhe Milot, ku u pritën me nderime ushtarake nga trupat pushtuese serbe, mbërritën në Tiranë. Një javë më vonë, mbi 1 800 ushtarë turq u larguan me anije për në Stamboll, ndërsa vullnetarët e Shqipërisë së Mesme pas një parakalimi në Tiranë u shpërdanë në qytetet e tyre.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE**MBYLLJA E
SPORTELEVE FIZIKE
NË INSTITUCIONET
SHTETËRORE**

NGA 1 MAJ 2022

SHËRBIMET OFROHEN**ONLINE**

në:



e-albania.al

**24 ORË PA PUSHIM
NË SHËRBIMIN TUAJ!**